

Raporti i Investimeve te Huaja Direkte në Shqipëri, 2010

Dhjetor 2010

PASQYRA E LËNDËS

Dy fjalë falenderimi.....

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....

HYRJE.....

KAPITULLI I. Investimet e huaja direkte në Shqipëri (IHD): TENDENCAT, KARAKTERISTIKAT KRYESORE, ROLI I TYRE NE EKONOMINE E VENDIT

A. IHD-të në Shqipëri në kontekstin global.....

B. Fluksi i investimeve të huaja direkte dhe rëndësia e tyre për investimet në Shqipëri në përgjithësi dhe për bilancin e pagesave

C. Karakteristikat kryesore të fluksit të IHD-ve.....

1. IHD-të sipas formës.....

2. IHD-të sipas mënyrës së hyrjes dhe aktivitetit ekonomik.....

D. Karakteristikat kryesore të stokut së investimeve të huaja direkte në Shqipëri.....

1. Stoku i IHD sipas formës

2. Stoku i IHD-ve hyrëse në Shqipëri sipas aktiviteteve kryesore ekonomike

3. Stoku i IHD-ve në Shqipëri sipas vendit investues

E. Efektet e investimeve të huaja direkte: roli i filialeve të huaja në ekonominë shqiptare.....

KAPITULLI II. ROLI DHE IMPAKTI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË SHËRBIMET NË SHQIPËRI.....

A. Investimet e huaja direkte në shërbimet e telekomunikacionit

B. Investimet e huaja direkte në shërbimet bankare

C. Investimet e huaja direkte në shërbimet e sigurimeve

D. Konkluzionet

KAPITULLI III. KUADRI REGULLATOR DHE MJEDISI I BIZNESIT PËR IHD-të NË SHQIPËRI.....

A. Mjedisi në ndryshim për biznesin

1. Vlerësime krahasimore ndërkombëtare.....

2. Politika për IHD-të: regjimi i investimeve

3. Reformat e kohëve të fundit

B. Masat e parashikuara për përmirësimin e mjedisit të biznesit

C. Vlerësimi i mjedisit ligjor dhe institucional në Shqipëri: rezultatet e një sondazhi.....

D. Konkluzione në lidhje me politikat

Kutitë

- Kutia I.1. Investime të huaja direkte në biznese të reja sipas të dhënave të kompanive bazuar në raportimet e shtypit.....
- Kutia I.2. Marrëveshjet kryesore të privatizimit ku janë përfshirë investime të huaja direkte në Shqipëri gjatë vitit 2009
- Kutia I.3. Shënim metodologjik mbi të dhënat e stokut të investimeve të huaja direkte të mbledhura nga Banka e Shqipërisë
- Kutia III.1. Karakteristikat e sondazhit mbi kuadrin e politikave në Shqipëri.....

Figurat

- Figura I.1. Përqindja e fluksit të IHD-ve shqiptare në vendet e Evropës Juglindore dhe në botë
- Figura I.2. IHD-të hyrëse në Shqipëri, 2004-2009
- Figura I.3. IHD-të dalëse nga Shqipëria, 2004-2009
- Figura I.4. Shqipëria: Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe investimet e huaja direkte përkundrejt GDP-së, 2004-2009
- Figura I.5. Shqipëria: përbërja e fluksit të IHD-ve, sipas formës për periudhën 2008-2009
- Figura I.6. Shqipëria: kontributi i privatizimit në lidhje me fluksin e IHD-ve, periudha 2003-2009
- Figura I.7. Shqipëria: Stoku i IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik, periudha 2007-2008
- Figura I.8. Shqipëria: ndarja gjeografike e rezervës së IHD-ve hyrëse sipas burimit, viti 2008 .
- Figura I.9. Përqindja e filialeve të huaja në ekonominë shqiptare, sipas treguesëve të ndryshëm, viti 2008.....
- Figura I.10. Shqipëria: shpërndarja e filialeve të huaja sipas aktivitetit ekonomik, viti 2008.....
- Figura I.11. Shqipëria: xhiroja e filialeve të huaja sipas aktivitetit ekonomik, viti 2008
- Figura I.12. Përqindja e filialeve të huaja në manufakturë në Shqipëri, tregues të përzgjedhur, viti 2008.....
- Figura I.13. Përqindja e filialeve të huaja në vlerën e shtuar dhe në punësim, Shqipëria dhe disa ekonomi të përzgjedhura evropiane, viti 2006.....
- Figura I.14. Përqindja e filialeve të huaja në vlerën e shtuar në industri, vende të përzgjedhura, viti 2006.....
- Figura II.1. Përqindja e penetrimit të operatorëve të telefonisë fikse dhe asaj të lëvizshme, për vende të përzgjedhura.....
- Figura II.2. Përqindja e bankave të huaja në totalin e aseteve bankare të Evropës Juglindore, vitet 2002, 2008.....
- Figura II.3. Huatë e këqia në disa vende të përzgjedhura të Evropës Juglindore, periudha 2000-2008
- Figura II.4. Huatë bankare për sektorin privat jo-financiar, ndryshimi i përqindjes gjatë vitit pararendës, Shqipëria dhe vende të tjera të Evropës Juglindore
- Figura II.5. Përqindja e kredive të këqia në totalin e huave, Shqipëria dhe vende të tjera të Evropës Juglindore, shtator 2008-mars 2010
- Figura II.6. Shqipëria: ndarja e tregut të sigurimeve jo-jetë, sipas ofruesëve, viti 2008
- Figura II.7. Shqipëria: Ndarja e tregut të sigurimit të jetës sipas ofruesëve, viti 2008.....
- Figura III.1. Lehtësia e të bërit biznes: renditja globale e Shqipërisë dhe vendeve të tjera sipas Bankës Botërore në vitin 2010

Figura III.2. Sa të kënaqura janë filialet e huaja me kuadrin ligjor të biznesit në Shqipëri.....
Figura III.3. Sa i njohin dhe sa i përdorin filialet e huaja strukturat mbështetëse të biznesit

Tabelat

Tabela I.1. Fluksi i IHD-ve: Bota, Evropa Juglindore dhe Shqipëria
Tabela I.2. Renditja e Shqipërisë sipas Indeksit të Performancës së IHD-ve Hyrëse dhe Indeksit Potencial të IHD-ve, për vitet e përzgjedhura
Tabela I.3. Fluksi i IHD-ve si përqindje e formacionit të kapitalit fiks bruto, vendet e Evropës Juglindore, 2004-2009
Tabela I.4. Treguesit e sektorit të jashtëm, nominalë dhe si përqindje e GDP-së.....
Tabela I.5. Përbërja e fluksit vjetor dhe tremujor të IHD-ve, 2008-2009
Tabela I.6. Pagesat e të ardhurave të IHD-ve dhe fitimet e ri-investuara, 2008
Tabela I.7. IHD në biznese të reja në Shqipëri: kompanitë kryesore investuese, 2003-2009.....
Tabela I.8. Fluksi i IHD-ve sipas aktiviteteve ekonomike
Tabela I.9. Komponentët e stokut të investimeve të huaja direkte hyrëse dhe dalëse, 2003-2008
Tabela I.10. Stoku i IHD-ve hyrëse si përqindje e GDP-së në Shqipëri dhe në vendet e tjera të Evropës Juglindore
Tabela I.11. Përbërja e ndryshimit në stokun e IHD-ve hyrëse dhe dalëse, Shqipëria, 2007-2008.....
Tabela I.12. Shqipëria: Numri i projekteve të investimeve dhe stoku i IHD-ve hyrëse, sipas llojit të aktivitetit ekonomik, 2007-2008.....
Tabela I.13. Stoku i IHD-ve në Shqipëri sipas rajonit dhe vendit të origjinës, 2004-2008.....
Tabela I.14. Përqindja e filialeve të huaja në ekonominë shqiptare, sipas llojit të industrisë, tregues të ndryshëm, 2008.....
Tabela II.1. Vlera bruto e shtuar, sipas llojit të veprimtarisë ekonomike, për vitin 1992 dhe për periudhën 2002-2008.....
Tabela II.2. Numri i abonentëve të telefonisë të lëvizshme dhe atyre të telefonisë fikse në Shqipëri, për periudhën 2003-2008
Tabela II.3. Treguesit kryesorë të nivelit të sistemit bankar në Shqipëri.....
Tabela II.4. Bankat në Shqipëri sipas pronësisë, 2008.....

Shënim

Termet vend/ekonomi sipas përdorimit në këtë raport u referohen gjithashtu edhe teritoreve apo zonave. Grupimet kryesore të vendeve sipas përdorimit të tyre në këtë *Raport* ndjekin klasifikimet e Zyrës së Statistikave të Kombeve të Bashkuara. Këto klasifikime janë si më poshtë vijon:

Vende të zhvilluara: vendet anëtare të OECD-së (me përjashtim të Kilit, Meksikës, Republikës së Koresë dhe Turqisë), plus vendet e reja anëtare të Bashkimit Evropian që nuk janë anëtare të OECD-së (Bullgaria, Qiproja, Estonia, Letonia, Lituania, Malta, Rumania dhe Sllovenia), plus Andorën, Izraelin, Lihtenshteinin, Monakon dhe San Marinon.

Ekonomi në tranzicion: Evropa Juglindore dhe Komunuelthi i Shteteve të Pavarura.

Ekonomi në zhvillim: në përgjithësi të gjitha ekonomitë që nuk specifikohen më lart. Për qëllime statistikore, të dhënat mbi Kinën nuk përfshijnë ato të Rajonit të vecantë administrativ të Hong Kongut (Hong Kong SAR), të rajonit të vecantë administrativ të Makaos (Macao SAR) dhe provincës së Taivanit në Kinë.

Në tabela janë përdorur simbolet e mëposhtme:

- Dy pikat (..) tregojnë se nuk disponohen të dhëna, ose që ato nuk janë të regjistruara vecmas. Reshtat në tabela mungojnë në ato raste kur nuk disponohen të dhëna për cilindo prej elementëve të atij rreshti;
- Kjo vizë (–) tregon që artikulli është i barabartë me zero apo që vlera e tij është e papërfillshme;
- Një hapësirë bosh në një tabelë tregon se artikulli/njësia nuk është i zbatueshëm, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe;
- Kjo vizë (/) midis datave që përfaqësojnë vite si p.sh. 1994/95 ka kuptimin e një viti financiar;
- Kjo vizë (–) midis datave që përfaqësojnë vite, si p.sh. 1994–1995 përfshin të gjithë periudhën në fjalë, duke përfshirë fillimin dhe fundin e viteve;
- Në rastet kur në tekst ka një referencë ndaj monedhës së “dollarit” (\$), kjo do të nënkuptojë dollarë amerikanë, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe;
- Përqindjet vjetore të rritjes ekonomike apo ndryshimeve u referohen normës vjetore të përbërë, me përjashtim të rasteve kur në tekst specifikohet ndryshe;

Detajet dhe përqindjet në tabela jo domosdoshmërisht u korespondojnë totaleve për shkak të rumbullakosjes.

Materiali i këtij raporti mund të përdoret si referencë, por gjithmonë me kuotimet përkatëse.

Dy fjalë falenderimi

Raporti mbi Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri 2010 është botimi i parë i një Raporti që qeveria shqiptare ka planifikuar të publikojë regullisht, në përputhje me një Urdhër të Këshillit të Ministrave nr. 169 të datës 23.11.2009. Ky raport është produkt i bashkëpunimit me Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), si edhe Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (PNUD) në Shqipëri. Ky bashkëpunim me UNCTAD-in dhe PNUD-in do të vijojë edhe në raporte të ardhshme.

Raporti është frut i punës të përbashkët të Ekipit Kombëtar të Investimeve të Huaja Direkte dhe z. Gabor Hunya, ekspert ndërkombëtar për IHD-të dhe konsulent i UNCTAD-it. Ekipi shqiptar që punoi për IHD-të përbëhet nga Bashkim Sykja (Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës), Diana Shtylla dhe Godiva Rembeci (Banka e Shqipërisë), Elsa Dhuli dhe Eriola Karpuzi (INSTAT-i), Marinela Jazoj (Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri), Diana Leka (PNUD-it, Shqipëri), Elton Nastasi (Albinvest-i), Tomi Kola dhe Sokol Ibraj (Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Biznesit), Sajmir Boka dhe Kujtime Stefani (Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës). Raporti është koordinuar në të gjithë fazat e tij nga Diana Leka në zyrën e PNUD-it në Shqipëri dhe nga Astrit Sulstarova nga UNCTAD-i, nën mbikqyrjen dhe udhëzimin e përgjithshëm të Masataka Fujita nga UNCTAD-i, Enno Bozdo, përfaqësues i qeverisë shqiptare, Arben Rama, përfaqësues nga zyra e PNUD-it në Shqipëri. Gjithashtu kanë kontribuar me komente të rëndësishme: Padma Mallampally, eksperte ndërkombëtare për IHD-të dhe Kalman Kalotay nga UNCTAD-i. Komente dhe sugjerime të tjera në këtë raport janë ofruar nga Ahmet Mancellari, Erjon Luci, Altin Tanku. Mbështetje statistikore është ofruar nga Besa Menzelxhiu dhe Dorin Rama(praktikant) pranë zyrës së PNUD-it. Dëshirojmë gjithashtu të falenderojmë edhe përkthyesen e këtij raporti në gjuhën shqipe Evis Cerga (Gjikondi).si edhe kompanine Alb-Design qe mundesoi dizenjimin dhe publikimin e raportit.

Pergatitja e raportit eshte aktivitet ne kuadrin e projektit “Nje OKB Mbeshtetje per HDI ne Shqiperi ”

Përfitojmë nga rasti për të vlerësuar mbështetjen financiare të PNUD-it në Shqipëri.

Përmbledhje Ekzekutive

- Fluksi i investimeve të huaja direkte (IHD) në Shqipëri është rritur ndjeshëm, nga 258 milionë euro në vitin 2006, në 705 milionë euro në vitin 2009. Investimet e huaja direkte janë zhvilluar pavarësisht nga tendencat globale dhe rajonale gjatë krizës ekonomike dhe financiare, duke dëshmuar për një rritje të vazhdueshme deri në vitin 2009.
- Megjithatë, rritja e fluksit të IHD-ve në Shqipëri mund të jetë e vështirë për tu ruajtur edhe gjatë vitit 2010, për shkak të kushteve të disfavorshme ekonomike ndërkombëtare dhe investimeve me një ritëm të ngadalësuar nga jashtë nga disa prej vendeve kryesore të origjinës së korporatave shumëkombëshe (TNC) që investojnë në Shqipëri.
- Sipas Indeksit të Performancës së IHD-ve të UNCTAD-it për vitin 2009, Shqipëria renditet në vend të 25-të nga 141 vende, gjë që përfaqëson një përmirësim të shpejtë nga pozicioni i 80-të që Shqipëria mbante në vitin 2006. Ky përmirësim në renditje është pjesërisht rezultat i rritjes së shpejtë të fluksit të IHD-ve në vend, kryesisht si pasojë e një mjedisi të përmirësuar biznesi, si edhe falë mundësive të krijuara nga privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore.
- Fluksi i IHD-ve arrinte në një të pestën apo më shumë të vlerës së kapitalit bruto vendas dhe përgjigjej për financimin e gjysmës së deficitit të llogarisë korrent gjatë periudhës 2008-2009.
- Prodhimi zë një përqindje relativisht të ulët të IHD-ve në Shqipëri, me më pak se një të pestën e stokut të IHD-ve për vitin 2008. Pjesën dërmuese e zënë shërbimet; transporti, komunikacionet dhe shërbimet e magazinimit zinin 23%, ndërsa shërbimet financiare zinin një të tretën e stokut të IHD-ve në vitin 2008.
- Filialet e huaja luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë shqiptare përsa u takon aktiviteteve të investimeve, vlerës së shtuar, prodhimit dhe punësimit. Të dhënat e një sondazhi të INSTAT-it për vitin 2008 tregojnë se ndërmarrjet me pronesi me shume se 50% të huaj përgjigjeshin për 41% të totalit të investimeve, 39% të totalit të vlerës së shtuar, 27% të totalit të xhiros dhe 16% të totalit të punësimit.
- Shkalla e pjesëmarrjes të filialeve të huaja në ekonominë shqiptare është e ngjashme me atë të vendeve të Evropës Qendrore: si p.sh. Republika Çeke dhe Sllovakia që renditen ndër vendet me treguesit më të lartë të kësaj pjesëmarrjeje në Evropë. Pjesëmarrja e lartë e kompanive të huaja është tregues i kushteve të favorshme për IHD-të në disa industri në vend, por është në të njëjtën kohë edhe shenjë e dobësisë së kompanive vendase, duke përfshirë edhe sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NMV) që nuk ka nivelin e duhur të zhvillimit.
- Filialet e huaja në Shqipëri janë të shpërndara në mënyrë disproporcionale në të gjithë ekonominë. Ndonëse ato në një farë mase nxisin industrializimin e vendit, angazhimi i tyre në aktivitetet e teknologjisë së lartë është i kufizuar.
- Hendeku i produktivitetit të krahut të punës midis filialeve të huaja dhe ndërmarrjeve vendase në Shqipëri është relativisht i ngushtë në industrinë e prodhimit, cka flet për

një nivel relativisht të ulët teknologjik të filialeve të huaja, gjë që pjesërisht mund të reflektojë mungesën e krahut të punës të kualifikuar.

- Futja e investitorëve të huaj në një shkallë të madhe në shërbimet financiare dhe ato të telekomunikacionit ka zgjeruar gamën dhe ka rritur efikasitetin e këtyre shërbimeve.
- Shqipëria ka miratuar një kuadër të favorshëm politikash për investimet e huaja direkte qysh nga viti 1993, ndërsa kohët e fundit ka ndërmarrë politika të tjera për mbështetjen e zhvillimit të sektorit privat në përgjithësi. Gjithashtu, po ndërmerren masa për përmirësimin e mëtejshëm të mjedisit të biznesit, duke përfshirë ndër të tjera, edhe një reformë të agjencisë që përgjigjet për nxitjen e investimeve.
- Në një sondazh të filialeve të huaja të kryer enkas për këtë raport, investitorët e huaj bëjnë një vlerësim pozitiv në përgjithësi përse i takon politikave ekonomike dhe masave të ndryshme legjislative, si p.sh. atyre që lidhen me tatimet, punësimin dhe mjedisin. Megjithatë, ka ende një lloj pakënaqësie në lidhje me programet e mbështetjes së qeverisë. Problemi më i madh i evidentuar është se më shumë se gjysma e investitorëve nuk gjejnë dot njerëz me aftësi të përshtatshme profesionale. Për më tepër, investitorët kërkojnë ndërmarrjen e hapave për përmirësimin e zbatimit të legjislacionit, vjeljes së taksave rimbursimitin e TVSH-së dhe një ulje të burokracisë.

HYRJE

Zhvillimi i shpejte ekonomik dhe rruga drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, janë prioritetet kryesore të axhendes të qeverisë shqiptare. Politikat kryesore të vendit janë drejtuar drejt liberalizimit të kuadrit ekonomik, përmirësimit të kushteve të biznesit dhe thithjes së investimeve të huaja direkte (IHD), si një objektivi i rëndësishëm. Falë progresit të bërë për transformimin ekonomik dhe mjedisit të jashtëm mbështetës, rritja ekonomike e Shqipërisë gjatë periudhës midis viteve 2000-09 ka qënë e shëndoshë. Gjatë kësaj periudhe, Shqipëria arriti një rritje mesatare vjetore të GDP-së me 6%. Gjithësesi, GDP-ja për frymë sipas barazisë së fuqisë blerëse është vetëm 25% e mesatares të EU-27, më e ulët sesa e Bullgarisë- që është shteti anëtar i BE-së me të ardhurat më të ulta.¹ Rrjedhimisht, mbetet shumë punë për tu bërë për të arritur vendet e tjera dhe roli potencial i investimeve të huaja direkte në transferimin e kapitalit dhe teknologjive është i pacmueshëm.

Shqipëria është një vend i vogël, me vetëm 3.2 milionë banorë. Në krahasim me vendet e tjera të Evropës Juglindore, ajo radhitet në nivel mesatar ekonomik në terma të GDP-së.² Në vitin 2009, GDP-ja nominale e Shqipërisë sipas kursit të këmbimit të asaj periudhe ishte 9 miliardë euro, pra sa trefishi i GDP-së së Malit të Zi dhe mbi 50% të GDP-së të ish- Republikës Jugosllave të Maqedonisë, porse sa një e katërta e asaj të Kroacisë. Kur vjen fjala për thithjen e IHD-ve, madhësia, ashtu sikundër niveli i zhvillimit dhe pozita gjeografike, luan një rol të rëndësishëm. Zakonisht vendet e vogla nuk ia dalin mbanë të tërheqin shoqëri shumëkombëshe dhe industri që prodhojnë për tregjet e eksportit të një shkalle të madhe. Ndonëse kjo kufizon shkallën e konkurrencës me vende pritëse më të mëdha dhe me kosto të ulët në thithjen e IHD-ve të orientuara nga eksporti nga një sërë burimesh, Shqipëria, me krahun e saj të lirë dhe të motivuar të punës gëzon një potencial të mirë për tu shndërruar në një qendër/bërthamë manufakture dhe shërbimesh për eksportet me Italinë dhe Greqinë, që përfaqësojnë njëkohësisht tregjet kryesore të rajonit.

Në vitin 2009, ekonomia shqiptare njohu një rritje të shëndoshë prej 3.3%, pavarësisht nga kriza financiare dhe recesioni ekonomik i vendeve të tjera evropiane dhe nga rënia që shoqëroi eksportet shqiptare dhe remitancat. Ndikimi i krizës ndërkombëtare financiare dhe ekonomike për Shqipërinë u zbut nga rëndësia e kufizuar e eksporteve për ta transmetuar krizën në vend, dhe nga vartësia relativisht modeste e Shqipërisë nga tregjet ndërkombëtare financiare. Ndër efektet e tjera stabilizuese mund të përmendim: kuadrin e politikave monetare, mbikëqyrjen e kujdesshme të sektorit bankar dhe kursin fleksibël të këmbimit. Disbalancat e huaja financiare nuk e kufizuan rritjen ekonomike për shkak se financimi i një deficiti të madh dhe madje në rritje të llogarisë korente mund të arrihej në një shkallë të madhe përmes shtimit të fluksit të IHD-ve nga privatizimet. Si pasojë e efekteve pozitive të privatizimit dhe IHD-ve, oferta dhe cilësia e shërbimeve utilitare shënoi përmirësim, duke garantuar një stimulim të aktivitetit ekonomik.

Rritja ekonomike parashikohet të vijojë edhe gjatë vitit 2010. Parashikimi për rritjen ekonomike për vitin 2010 në tërësi është në nivelin 3.0% (BERZH, 2010a). Rritja e ngadaltë ekonomike parashikohet të shkojë dora - dorazi me një rënie të fluksit të IHD-ve. Kjo korespondon me tendencën e vëzhguar në të gjitha vendet e tjera të rajonit,³ si edhe reflekton

¹ "GDP-ja për popullatë ndryshonte nga një në gjashtë në vendet anëtare të EU27 " Deklaratë për shtyp e Eurostat-it 9/2009..

² Evropa Juglindore përfshin: Shqipërinë, Bosnje- Hercegovinën, Kroacinë, Serbinë, Malin e Zi dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

³ Gábor Hunya (2010).

njëherazi aktivitetin e kufizuar të investimeve të kompanive shumëkombëshe evropiane (investitorët më të rëndësishëm në vendet e Evropës Juglindore).

Në kontekstin e rrethanave sfiduese në fjalë bëhet edhe më i rëndësishëm fakti që qeveria shqiptare ka hyrë tashmë në rrugën e reformave ekonomike, duke i vënë, ndër të tjera, rëndësi të vecantë trainimit dhe kualifikimit të krahut të punës, mbështetjes së zhvillimi të sektorit privat dhe investimeve ndërkombëtare në vend. Në lidhje me këto të fundit, synimi është thithja e më shumë investimeve të reja të huaja direkte dhe IHD në industrinë që prodhojnë për eksport, ato që përmirësojnë infrastrukturën ekonomike dhe ato që kontribuojnë në një rritje të nivelit teknologjik të vendit.

Në kapitujt pasardhës, ky raport si fillim hedh dritë mbi përvojën e Shqipërisë në lidhje me investimet e huaja direkte, duke u përqëndruar tek tendencat e fluksit të IHD-ve në vend, rëndësinë e tyre për bilancin e pagesave të vendit, karakteristikat kryesore dhe modelet e investimeve të huaja direkte, si edhe rëndësinë relative të veprimtarive të filialeve të huaja në ekonominë shqiptare. Raporti, gjithashtu merr në shqyrtim rolin dhe ndikimin e investimeve të huaja direkte në lidhje me shërbimet dhe ekonominë. Së fundi, raporti merr në shqyrtim mjedisin regullator dhe atë të biznesit në lidhje me IHD-të në vend dhe parashtron opsione politikash dhe masa që mund të kontribuojnë në përpjekjet që po bën qeveria për përpilimin e një politike më efikase dhe më të targetuar për investimet e huaja direkte.

KAPITULLI I. INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI: TENDENCAT, KARAKTERISTIKAT KRYESORE DHE ROLI I TYRE NË EKONOMINË E VENDIT

A. Investimet e huaja direkte në Shqipëri, në kontekstin global

Flukset globale të IHD-ve u dyfishuan gjatë periudhës 2005-2007 (në terma nominale), por në vitin 2009 ato ranë në nivelin e tyre të vitit 2005 me **802 miliardë euro** (1.1 triliardë dollarë) (tabela I.1). Fluksi i investimeve të huaja direkte në Evropën Juglindore ndoqi tendencën globale, duke shënuar kulmin në vitin 2007. Megjithatë, fluksi i IHD-ve në Shqipëri gjatë periudhës në fjalë u zhvillua pothuajse në mënyrë të pavarur nga tendencat globale dhe rajonale, duke dëshmuar një rritje të vazhdueshme që zgjati edhe përtej vitit 2009 (tabela I.1). I shprehur në dollare, gjithësesi, fluksi i IHD-ve në Shqipëri pësoi një rënie të lehtë, për shkak të vlerësimit të dollarit përkundrejt monedhës së euros dhe monedhës vendase (Lekut).


**Table I.1. HDI-te Hyrse: Bota, Europa Juglindore dhe Shqiperia
(Milion euro)**

Ekonomite pritese	2005	2006	2007	2008	2009
Bota	782 673	1 164 682	1 534 682	1 208 931	802 041
Europa Juglindore	3 870	7 885	9 384	8 663	5 446
Shqiperia	212	258	484	674	705

Burimi: UNCTAD, *WIR10*.

Përqindja e fluksit të investimeve të huaja direkte drejt Shqipërisë në krahasim me totalin botëror mbetet insinjifikative, tek 0.1% në vitin 2009, ndonëse investimet e huaja direkte shënuan një rritje sa dhjetëfishi i tyre i vitit 2000 (figura I.1). Megjithatë, pesha e vendit si vend pritës i investimeve të huaja direkte në rajonin e Europës Juglindore është rritur ndjeshëm qysh nga viti 2006, e në vecanti nga viti 2007, vit kur vala e investimeve të huaja direkte drejt Europës Juglindore njohu një rënie, ndërsa fluksi i tyre në Shqipëri vazhdonte të rritej (tabela I.1, figura I.1).

**Figura I.1. Përqindja e fluksit të IHD-ve të Shqipërisë në Europën Juglindore dhe në
botë
(si përqindje)**



Burimi: baza e të dhënave e UNCTAD-it, IHD/TNC (www.unctad.org/FDIstatistics).

Tabela 1.2. Renditja e Shqipërisë sipas Indeksit të Performancës së IHD-ve hyrëse, dhe Indeksit Potencial të IHD-ve hyrëse., disa vite.

	1995	2000	2005	2006	2007	2008	2009
Indeksi i performancës të IHD-ve hyrëse	40	58	67	80	53	35	25
Indeksi potencial i IHD-ve hyrëse	112	101	82	83	82	79 ... ^a	

Burimi: UNCTAD, WIR 2010, Tabelat Anekse

Viti i fundit për të cilin disponohen të dhëna për disa nga variablat e përfshira në Indeksit Potencial të IHD-ve hyrëse është 2008

Shqipëria pozicionohet relativisht lart në renditjen globale të bazuar në Indeksin e Performancës së IHD-ve Hyrëse të UNCTAD-it. I cili mat masen relative të IHD-ve që një vend merr në raport me madhësinë e ekonomisë së tij. Kjo e fundit, perlogaritet si përqindje e IHD-ve të një vendi në fluksin e IHD-ve globale me përqindjen e GDP-së globale. Rënditja e fundit në lidhje me këtë tregues (për vitin 2009) e vendoste Shqipërinë në vendin e 25-të midis 141 vendeve (tabela 1.2). Kjo përfaqëson një përmirësim të shpejtë nga vendi i 80-të, vend në të cilin Shqipëria klasifikohet në vitin 2006 (tabela 1.2). Pesë vjet më parë, Shqipëria renditej pas Polonisë, ndërsa tani pas Kilit, që është një ndër vendet me ekonomi më të orientuar drejt IHD-ve në botë (UNCTAD, WIR06 dhe WIR10). Ky përmirësim në renditje është pjesërisht rezultat i rritjes së shpejtë të fluksit të IHD-ve në vend, kryesisht si reagim i një mjedisi të përmirësuar biznesi dhe mundësive të reja të krijuara nga privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore.


Rënditja e Shqipërisë sipas Indeksit të Performancës të IHD-ve është më e favorshme sesa renditja e saj sipas Indeksit Potencial të IHD-ve hyrëse, sipas të cilit Shqipëria renditej në vendin e 79-të në vitin 2008 (viti i fundit për të cilin disponohen të dhëna), shumë më pas vendeve të tjera evropiane (renditja sipas Indeksit të Performancës të IHD-ve për të njëjtin vit

është në vendin e 35-të). Indeksi Potencial i IHD-ve hyrëse bazohet në 12 tregues, duke përfshirë ndër të tjera edhe nivelin e zhvillimit në përgjithësi dhe atë të infrastrukturës në vecanti (*UNCTAD, WIR02*). Mospërputhja midis performancës dhe potencialit tregon se pavarësisht nga një infrastrukturë e dobët, me mungesa në energji elektrike dhe aktivitet modest kërkimor-shkencor dhe zhvillimi, Shqipëria ka patur mundësi për investime që kanë inkurajuar fluksin e IHD-ve në vend, pas hapjes të plotë të këtij të fundit drejt investimeve të huaja. Por, Shqipëria duhet të përmirësojë potencialin e IHD-ve përpara se të shohë më shumë investime të huaja direkte, e në vecanti investime në biznese të reja në sektorë të ndryshëm prodhues. Sikundër theksohet edhe në seksionin e politikave të këtij raporti, kohët e fundit në Shqipëri është ndjerë një zhvillim i shpejtë pikërisht në ato fusha të infrastrukturës si: furnizimi me energji elektrike dhe rrugët, të cilat ishin evidentuar si pengesa në krahasimet ndërkombëtare. Kompani të huaja kanë përfituar koncensione për zhvillimin e këtyre fushave dhe po përmirësojnë kushtet për përmirësime të mëtejshme në sektorët e tjerë.

B. Fluksi i IHD-ve dhe pesha e tyre për investimet dhe bilancin e pagesave në Shqipëri

Përpara vitit 2006, fluksi i investimeve të huaja direkte në Shqipëri ishte relativisht i ulët dhe erdhi duke u rritur me ritme të ngadalta. Qysh nga ai vit, investimet e huaja direkte kanë shënuar një rritje të vazhdueshme në terma nominale në euro.⁴ Rritjet më të qenësishme i takojnë viteve 2007 dhe 2008. Në vitin 2009, rritja ishte e moderuar, por gjithësesi e bëri vendin një rast unik mes vendeve evropiane, shumica e të cilave pësuan rënie të fluksit të investimeve të huaja direkte në vendet e tyre për shkak të krizës financiare. Sic është theksuar, ndonëse shuma nominale e investimeve të huaja në Shqipëri është e një rëndësie modeste për shkak të shkallës së ulët dhe prapambetjes relative të vendit, e krahasuar me nivelin e zhvillimit ajo është gjithësesi tepër e **qenësishme**.

Figura I.2. IHD hyrëse në Shqipëri, 2004-2009
(në milionë euro)



Burimi: baza e të dhënave e UNCTAD, IHD/TNC (www.unctad.org/FDIstatistics) bazuar në të dhëna të marra nga Banka e Shqipërisë.

Shkalla e fluksit të investimeve të huaja direkte si përqindje e kapitalit fiks bruto (Gross fixed capital formation –GFCF) jep një tregues të përafërt të shkallës së fluksit të investimeve të huaja direkte në krahasim me totalin e investimeve në ekonomi (tabela I.3).⁵ Ky tregues ka shënuar një rritje nga më pak se 10% që ishte në vitin 2005 tek mbi 19% në vitin 2008 dhe duke arritur afërsisht në 23% në vitin 2009. Midis vendeve të rajonit, vetëm Mali i Zi ka tërhequr shumë më tepër investime të huaja direkte në krahasim me GFCF-në, si për shkak të nivelit të lartë të investimeve të huaja, ashtu edhe për shkak të vlerave të ulëta të

⁴ Të dhënat e fluksit, sipas Bankës së Shqipërisë, (BSH) në bilancin e pagesave janë marrë nga raportet mujore të raportimit në sistemin bankar, si edhe nga raportimet direkte nga një numër i kufizuar kompanish. Të dhënat e stokut vijnë nga sondazhet vjetore me kompanitë gjatë periudhës 2006-2008. Të gjitha të dhënat janë të raportuara në Euro.

⁵ IHD nuk është domosdoshmërisht pjesë e GFCF-it sepse në mbledhjen e të dy të dhënave nuk ndiqet e njëjta metodologji. Ndermjet të tjerave, bashkimet dhe blerjet nderkufitare edhe pse janë pjesë e IHD-ve nuk bëjnë pjesë në GFCF neqoftese ato blejnë aksionet ekzistuese.

GFCF-it. Në vitin 2008, në Shqipëri, raporti i GFCF-së kundrejt GDP-së ishte 41%, pra shumë më i lartë nga cdo vend tjetër i rajonit. Një nivel kaq i lartë investimesh është mbështetës për rritjen ekonomike, në vecanti po të marrim në konsideratë faktin se pjesa më e madhe e investimeve kanë qënë për sektorin e infrastrukturës duke lehtësuar investimet në biznes, përfshirë këtu edhe investimet e huaja direkte.

Table I.3. Fluksi i IHD-ve si përqindje e GFCF, vendet e Europës Juglindore, 2004-2009

Rajoni/Vendi	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Europa Juglindore	17	21	37	36	29	22
Shqipëria	13	9	10	17	19	23
Bosnje Herzegovina	27	20	25	46	22	14
Kroacia	12	17	27	33	32	17
Mali i Zi	18	118	105	78	53	177
Serbia	21	33	71	37	26	22
Fyrom (Maqedonia)	34	10	37	44	28	13


Burimi: UNCTAD, WIR10, tabelat anekse.

Flukset relativisht të larta të investimeve të huaja direkte në drejtim të Shqipërisë të shënuara gjatë periudhës 2007-2009 mund të mos vazhdojnë edhe gjatë vitit 2010 për shkak të kushteve ndërkombëtare më pak të favorshme. Investimet e huaja direkte nga vendet kryesore investuese në Shqipëri, si Italia dhe Greqia kanë pësuar rënie vitet e fundit. Po kështu ngadalësimi i ritmeve të aktiviteteve të investimeve dalëse nga vendet më aktive në investime mund të çojë në një ulje të mëtejshme të investimeve të huaja në Shqipëri në të ardhmen. Suksesi relativ që pati Shqipëria në thithjen e investimeve të huaja direkte gjatë periudhës 2007-2009, në rast se vendoset në kuadrin e rëniës së investimeve dalëse nga vendet kryesore origjinuese të investimeve të huaja direkte, sugjeron që shumë investitorë u tërhoqën nga mundësi të vecanta që kryesisht ishin vetëm për një herë të vetme. Sic do të shpjegohet në pjesën pasardhëse, arsyeja që tërhoqi ato lloj investimesh ishin pikërisht dhe kryesisht privatizimet e kompanive të utiliteteve. Këto mundësi zakonisht krijojnë një kulmim të investimeve të huaja direkte në vite specifike dhe flukset zakonisht bien në vitet pasardhëse në rast se nuk dalin mundësi të reja.

Fluksi i investimeve të huaja direkte ka qënë gjithashtu i rëndësishëm për bilancin e pagesave të vendit. Daljet e investimeve të huaja direkte nga Shqipëria, që do të thotë investime jashtë shtetit nga firma shqiptare – pothuajse të gjitha në ekonomitë e vendeve fqinje, në vecanti në Kosovë dhe në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë –janë modeste dhe përfaqësojnë vetëm afërsisht 6% të fluksit të IHD-ve hyrese për periudhën 2007-2009 (figura I.3).

Figura I.3. IHD-ve dalëse nga Shqipëria, 2004-2009
(në milionë euro)

Milione Euro



Burimi: baza e të dhënave e UNCTAD, IHD/TNC (www.unctad.org/FDIstatistics). Këto të dhëna janë të bazuara në informacionin e marrë nga Banka e Shqipërisë.

Rrjedhimisht, bilanci neto i fluksit të investimeve të huaja direkte është pozitiv. Ai ka financuar pothuajse gjysmën e deficitit të llogarise korrente gjatë viteve 2006 dhe 2009 (tabela I.4 dhe figura I.4), shumë më shumë nga vitet e mëparshme. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme për shkak se deficitit të llogarise korrente u trefishua gjatë periudhës midis viteve 2006 dhe 2008. Ndonëse deficitit të llogarise korrente u reduktua në mënyrë modeste në vitin 2009, ai gjithësesi arriti në 15% të GDP-së (tabela I.4), që është një ndër shifrat më të larta në Evropë.

Deficitit të llogarise korrente ka ardhur kryesisht si rezultat i deficitit të tregtisë me jashtë (tabela I.4). Rritja e importeve ishte pasojë e rritjes së konsumit privat dhe investimeve. Kapacitetet eksportuese kanë mbetur shumë të dobta; përqindja e eksportit të mallrave si përqindje e GDP-së, tek afërsisht 10% është një ndër më të ulëtat në Evropë. Njëkohësisht, bilanci i shërbimeve ka qënë gjithmonë e më shumë pozitiv. Në tërësi, eksportet shqiptare që në më të shumtën e herëve janë shërbime sesa mallra, një situatë që nuk është aspak e huaj për vendet e Mesdheut, duke përfshirë Greqinë dhe Kroacinë, ku turizmi kanë një përqindje më të lartë të GDP-së sesa manufaktura, ndërsa konkurrueshmëria ndërkombëtare e sektorit të shërbimeve është superiore ndaj atij të manufakturës. Kjo situatë është rezultat i zhvillimeve historike dhe kushteve natyrore dhe nuk mund të lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me efektet e IHD-ve, por është në përputhje me shpërndarjen e tyre sipas aktiviteteve ekonomike në të cilat, deri tani, manufaktura ka një pozitë relativisht të dobët dhe shërbimet një pozitë të fortë. Megjithatë, kjo tregon potencialin e investimeve të huaja direkte në manufakturë nga investitorët të huaj me avantazhe konkurruese në sektor.

Tabela I.4. Treguesit e sektorit të jashtëm, nominal dhe si % e GDP-së

(në milionë euro dhe %)

Zërat e bilancit të pagesave	2005	2006	2007	2008	2009
Llogaria rrjedhëse	- 589	- 471	- 831	- 1 370	- 1 327
<i>si % e GDP</i>	- 9	- 7	- 11	- 16	- 15
Eskportet e mallrave	530	631	786	917	751
<i>si % e GDP</i>	8	9	10	10	9
Bilanci i mallrave	- 1 477	- 1 659	- 2 104	- 2 431	- 2 304
<i>si % e GDP</i>	- 23	- 23	- 27	- 27	- 27
Eksportet e shërbimeve	967	1 157	1 415	1 688	1 718
<i>si % e GDP</i>	15	16	18	19	20
Bilanci i shërbimeve	- 140	- 32	13	69	121
<i>si % e GDP</i>	2.1	0.4	0.2	0.8	1.4
Fluksi IHD	213	259	481	675	698
<i>si % e GDP</i>	3	4	6	8	8
Investimet e huaja direkte dalëse	- 2	- 8	- 11	- 63	- 34
Bilanci për IHD (hyrëse- dalëse)	211	251	470	612	664
<i>si % e deficitit të llogarisë rrjedhëse</i>	36	53	57	45	50

Burimi Bazuar në të dhëna të marra nga Banka e Shqipërisë për të dhënat BoP, INSTAT për GDP 2005-2008 dhe Min Fin viti 2009

Figura I.4 Shqipëria: Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe IHD-të përkundrejt GDP-së.

2004-2009



Burimi: Bazuar në të dhëna të Bankës së Shqipërisë


Lloji i investimeve të huaja direkte nga të cilat Shqipëria ka përfituar deri tani është përqëndruar në prodhimin e shërbimeve për tregun vendas (pjesa I.D.2 dhe kapitulli II) duke gjeneruar më shumë importe sesa eksporte, të cilat mund të kontribuojnë në një deficit të llogarisë korrente në mungesë të shtesave në pjesë të tjera të asaj llogarie. Me maturimin e investimeve të huaja direkte në një vend të caktuar, investitorët rrisin të ardhurat, të cilat regjistrohen si dalje nga llogaria rrjedhëse dhe kjo rrit deficitet. Elemente të tjera si p.sh. mallrat dhe tepricat nga shërbimet që lidhen me tregëtinë shërbejnë si kundërpeshë përkundrejt efektit të mësipërm. Nga këndvështrimi i bilancit të pagesave, Shqipëria do të përfitonte nga thithja e më shumë IHD-ve që gjenerojnë eksport të mallrave dhe shërbimeve, përveç se i shërbejnë tregut vendas.

C. Karakteristikat strukturore të fluksit të investimeve të huaja direkte

1. Investimet e huaja direkte sipas formës

Pjesa dërrmuese e fluksit të investimeve të huaja direkte (IHD) në Shqipëri është në formën e kapitalit aksioner, që përbën afërsisht 70% të totalit. Fitimet e ri-investuara përbëjnë një përqindje më të vogël, ndonëse në rritje, ndërsa pjesa e kapitalit tjetër (që kryesisht janë huatë brenda kompanive) është pothuajse e papërfillshme (figura I.5 dhe tabela 1.5). Kjo përbërje e IHD-ve është një karakteristike për vendet në fazat e para të përfitimit të investimeve të huaja direkte; në vende ku kjo pjesë është më e maturuar rëndësia e kapitalit tjetër është zakonisht më e madhe. Duke mbajtur në konsideratë se shumica e projekteve të investimeve në Shqipëri janë të reja, një numër investitorësh po sjellin kapitale të reja në vend.

Figura I.5 Shqipëria: përbërja e fluksit të investimeve të huaja direkte sipas formës. 2008-2009



Burimi: Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë.

Tabela II.5 Shqipëria: Perberja e fluksit te IHD-ve vjetore dhe tremujore ,2008-2009

Perberja e IHD-ve	Q1- 08	Q2- 08	Q3- 08	Q4 - 08	2008	Q1- 09	Q2- 09	Q3- 09	Q4 - 09	2009
Fluksi I IHD-ve	87	133	216	239	675	123	307	156	112	698
Kapital aksioner	23	60	142	217	442	65	254	110	87	516
Fitime te ri-investuara	52	77	47	-5	171	51	42	57	72	222
Kapital tjetër	12	-3	27	27	63	7	11	-11	-47	-40

Burimi: UNCTAD IHD/TNC database www.unctad.org/ihdstatistics , sipas te dhenave te BSH

Fitimet e ri-investuara përfaqësojnë një komponent që po rritet, në rritjen nga viti në vit të IHD-ve në Shqipëri. Për vitin 2009, ato u vlerësuan të ishin 222 milionë euro, pra 50 milionë euro më shumë nga viti 2008. Tendenca pozitive flet për produktivitetin e investimeve të huaja direkte në vend dhe vendimin e investitorëve për tu sjellë fitime sipërmarrjeve të tyre në vend. Të ardhurat e investitorëve të huaj në Shqipëri në vitin 2008 arritën në 186 milionë euro, që korespondon me 9% të stokut të IHD-ve (tabela I.6). Ky është

një rendiment i mirë fitimi për investitorët, më i larti midis vendeve të Evropës Juglindore. Midis vendeve të Evropës Juglindore dhe vendeve të reja anëtare të Bashkimit Evropian të Evropës Qendrore dhe Lindore, atij ia kalon vetëm Hungaria, Republikën Çeke dhe Estoni, të gjitha prej të cilave kanë projekte të konsoliduara të investimeve të huaja direkte, që zakonisht kanë kapacitete më të larta për të siguruar të ardhura nga ato të projekteve të reja. Nga të ardhurat e siguruar nga IHD-të në Shqipëri, në vitin 2008 u ri-investuan 92% e tyre. Kjo është një përqindje shumë e lartë sipas krahasimeve ndërkombëtare dhe përbën një tjetër karakteristikë të sjelljes së investitorëve në fazat fillestare të projekteve të investimeve.

Tabela I.6. Shqipëria: Pagesat e të ardhurave nga IHD-të hyrëse, dhe fitimet e ri-investuara, 2008
(Në milionë euro dhe në %)

Daljet (borxhi)	2008
Të ardhura nga investimet direkte	186
Fitimet e riatdhesuaranga aksionet	9
Fitime të ri-investuara	171
Te ardhurat nga kredite	6
Stoku IHD (hyrëse)	1,986
Te ardhurat nga IHD hyrese si përqindje perkundrejt stokut te IHD-ve (Rendimenti i IHD-ve)	9%
Fitime të ri-investuara si % e të ardhurave nga IHD -te	92%

Burimi : Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë

Huatë brenda kompanive në përgjithësi demonstrojnë luhatje të mëdha nga viti në vit dhe kjo jo vetëm në Shqipëri. Fluksi i kredive për filialet e huaja në Shqipëri për herë të parë ishte negativ në vitin 2009, deri në masën prej afërsisht 40 milionë euro. Arësyet për këtë nuk janë të qarta, por përvoja është e ngjashme me atë të disa vendeve të tjera të rajonit në kuadrin e krizës financiare. Një nga shpjegimet mund të jetë që bankat e huaja dhe investitorët tjerë tërhiqen disa prej kredive që kishin ofruar më herët. Në disa raste filialet “në gjendje” në vendin pritës ka ndodhur që u kanë dhënë kredi kompanive mëma, të cilat mund të jenë prekur rëndë nga kriza financiare. Në vitin 2008, ndërmarrjet e investimeve të huaja në sektorin e telekomunikacionit ishin aktive në dhënien e huave direkte investitorëve të tyre (si p.sh.: AMC-ja i dha kredi kompanisë mëmë).

2. Investimet e huaja direkte sipas mënyrës së hyrjes dhe veprimtarisë ekonomike

Investimet e kapitaleve hyjnë në një vend në formën e investimeve në biznese të reja apo si bashkime dhe blerje ndër-kufitare (cross-border M&As). Sipas të dhënave të përpiluara nga UNCTAD-i (Kutia 1.1), gjatë periudhës 2003-2009, numri më i madh i projekteve në biznese të reja (nëntë) ishte në fushën e shërbimeve financiare (tabela I.7). Në industrinë e mëposhtme nisën shtatë projekte: në industrinë ushqimore, duhan, pije, qymyr, naftë dhe gaz natyror, si edhe në materiale ndërtimi. Në kategorinë e “aktivitetit të biznesit”, 44.5% e projekteve ishin në industrinë e nxjerrjes dhe në ndërtim, ku më shumë se një e treta e tyre ishte në industrinë e manufakturës. Pjesa tjetër (55.5%) ishin në shërbime si: shitjet me pakice (duke përfshirë shërbimet financiare), tregëti dhe shërbime biznesi. Ndër kompanitë investuese, Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve nga Shtetet e Bashkuara është kompania që qëndron “në krye të klasifikimit”, me pesë projekte të shpallura investimesh. Vendin e dytë e mban rrjeti Italian i supermarkatave “Conad”. Dhjetë kompanitë kryesore përgjigjeshin për 35% të projekteve të investimeve.

Kutia I.1. Përkufizimet dhe burimet e të dhënave mbi projektet e reja

Të dhënat e përdorura në këtë studim në lidhje me projektet e investimeve të reja janë të bazuara në informacionin e UNCTAD-it, sipas të dhënave nga tregjet e IHD-ve të Financial Times Ltd. FDI Markets (tregjet e IHD-ve) ndjek të gjitha projektet e reja të investimeve dhe ekspansionin e atyre ekzistuese, por pa dhënë informacion mbi pjesëmarrjen aksionere sipas investitorëve. Ndonëse nuk ka ndonjë shkallë minimale për një projekt për tu përfshirë, si kriter përzgjedhjeje për përfshirjen në këtë bazë të dhënash si projekt investimesh, projekti duhet të krijojë punësim të ri direkt dhe investim kapitali. Burimet e informacionit për mbledhjen dhe konfirmimin e këtyre projekteve përfshijnë lajmet nga gazeta “Financial Times” , afërsisht 9,000 burime të medias, të dhëna projektesh nga mbi 1,000 organizata të industrisë dhe agjenci investimesh, si edhe të dhëna të blera nga hulumtimi i tregut dhe kompanitë e botimeve. Të dhënat konfirmohen nga burime të ndryshme dhe mbi 90% e tyre konfirmohen me burimet e kompanive. Përsa i përket klasifikimit të industrive, cdo projekt IHD që ndiqet nga FDI Markets klasifikohet sipas grupit, sektorit dhe aktivitetit përkatës të biznesit, sipas një sistemi të klasifikimit të industrisë së pronësisë (). Duke qënë se në shumicën e rasteve vlera e projekteve nuk disponohet, të dhënat e mbledhura nga UNCTAD-i dhe të parqitura në Raportet e Investimeve Botërore, dhe deri tani kanë të bëjnë vetëm me numrin e rasteve të regjistruara.

Burimi: UNCTAD, WIR10.

Tabela I.7. IHD të reja në Shqipëri: kompanitë kryesore investuese, 2003-2009
(nr i projekteve të shpallura)


Kompania	Vendi i origjines	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Fondi Amerikano-Shqiptar i Ndermarrjeve	SHBA	1	1	2	1			
Conad	Itali				3		1	
Kurum	Turqi	1		1			1	
Rompetro	Rumani/Hollande				1	1		
Titan Cement	Greqi				1		1	
La Petrolifera Italo-Rumena (PIR)	Itali			1		1		
ProCredit Holding	Gjermani			1	1			
Moncada Costruzioni (Moncada Energy Group)	Itali							2
Fresh Property	Brit e Madhe							2
Ber Oner	Turqi	1						
Kompani te tjera		6	6	7	4	7	9	7
Totali		9	7	13	11	8	16	7

Burimi : baza e te dhenave UNCTAD IHD/TNC (www.unctad.org/FDI statistics) sipas tregut te IHD-ve te Financial Times Ltd.

Futja e IHD-ve përmes bashkimeve dhe blerjeve ndërkufitare në një ekonomi në tranzicion si Shqipëria zakonisht ndodh përmes privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore. Ka patur në fakt një fluks të madh të investimeve të huaja direkte në Shqipëri si rezultat i procesit të privatizimit, duke përfshirë si privatizimin e SME-ve në një numër industrish, ashtu edhe privatizimin e sipërmarrjeve të mëdha në industritë strategjike (si p.sh.: sistemi bankar, telekomunikacione dhe energjetikë), që kanë tërhequr pjesëmarrjen e korporatave shumëkombëshe (TNC). Gjatë viteve të fundit ka qënë kryesisht privatizimi i sipërmarrjeve/ndërmarrjeve të sektorëve strategjikë që ka siguruar flukse të larta të

investimeve të huaja direkte. Gjatë periudhës 2004-2008, 24% e totalit të investimeve të huaja direkte u siguroa nga privatizimet; në vitin 2009, kjo përqindje arrinte deri në 26% (figura I.6).

Figura I.6. Shqipëria: Kontributi i privatizimeve në fluksin e investimeve të huaja direkte, 2003 -2009 (në milionë dollarë)



Burimi: Bazuar në të dhënat e Bankës së Shqipërisë (BSH) për fluksin e IHD-ve dhe të dhënat e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si edhe të Ministrisë së Financave për fluksin e IHD-ve nga privatizimet.

Formatted: Not Highlight

Kështu, p.sh. gjatë një periudhe pesë vjecare nga viti 2005-2009 u privatizuan të gjitha bankat kryesore, ku disa prej tyre iu shitën bankave të vendeve të tjera. Në vitin 2008 u hartuan politika të reja zhvillimi për industri të tjera strategjike, si minierat dhe energjetika, të cilat bënë të mundur privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore në ato sektorë, duke përfshirë edhe shitjen e aksioneve tek firmat/shoqëritë e huaja. Disa prej marrëveshjeve të privatizimit të arritura gjatë vitit 2009 dhe ku përfshihen investime të huaja direkte jepen në Kutinë I.2.

Kutia I.2. Marrëveshje të rëndësishme privatizimi me përfshirjen e IHD-ve në Shqipëri në vitin 2009

Ndër marrëveshjet kryesore ku u përfshinë investime të huaja direkte në Shqipëri gjatë vitit 2009 mund të përmendim sa më poshtë vijon:

- Shitja e 12.6% të aksioneve të kompanisë të telefonisë të lëvizshme, AMC, tek grupi grek i telekomunikacionit, COSMOTE për 48.2 milionë euro;
- Shitja e 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të energjisë elektrike (OSSh) kompanisë ceke, CEZ për 102 milionë euro.
- Investime në industrinë e cimentos nga kompania Antea Cement (Itali), Colacem Shqiperia (Itali), Cementos Aguila (Itali).

- Licenca e katërt e telefonisë së lëvizshme iu shit Post-Telekomit të Kosovës për 7.5 milionë euro.

Burimi: UNCTAD, sipas të dhënave të Thomson Financial.

Përtej fluksit direkt të IHD-ve në formën e të ardhurave nga shitja e asetëve, privatizimi gjithashtu sjell investime pasuese në trajtën e shtimit të kapitalit të kompanisë së blerë.

Struktura e fluksit të IHD-ve në Shqipëri sipas sektorëve ekonomike kaloi përmes disa ndryshimeve të rëndësishme gjatë viteve 2006-2008, periudhë për të cilën disponohen të dhëna. U shënuan një rritje e shpejtë e investimeve në industri dhe ndërtim (tabela I.8). luhatjet e mëdha janë shprehje e marrëveshje të rëndësishme të privatizimit. Privatizimi i kompleksit të rafinerisë së naftës, ARMO, për 125 milionë euro ishte faktori kryesor që çoi në një rritje të shprehur të IHD-ve në prodhim gjatë vitit 2008 (tabela I.8).

Tabela I.8. Fluksi i IHD-ve sipas aktiviteteve ekonomike

(Milionë euro)

	2006	2007	2008
Bujqësi, gjueti dhe peshkim	2	2	- 54
Ndërtim	8	61	147
Industri	69	56	369
Energji elektrike dhe gaz	-	4	2
Sektori i shërbimeve	180	357	211
Telekomunikacione	62	196	- 61
Ndërmjetësim financiar	30	136	167
Total	259	481	675

Burimi : Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë

Niveli i lartë i investimeve të huaja direkte në sektorin financiar gjatë vitit 2008 ishin rezultat i blerjes të një pjese të aksioneve të Bankës Popullore dhe të bankës “Union Bank” nga investitorë të huaj. Kontributi i IHD-ve në ndërmjetësimin financiar kundrejt totalit të fluksit të investimeve të huaja mbeti i lartë gjithashtu edhe gjatë vitit 2008, me një përqindje prej 24% të totalit. Industria e manufakturës ka përfituar gjithashtu më shumë investime të huaja direkte vitet e fundit. Gjatë vitit 2008, përqindja e saj zinte mbi gjysmën e fluksit të IHD-ve. Industritë kryesore përfituese janë ato që punësojnë një numër të madh të fuqisë punëtore, duke përfshirë prodhimin e tekstileve dhe këpucëve që kanë tërhequr investitorë nga Italia dhe Greqia. Në vitin 2008, fluksi i IHD-ve në sektorin e ndërtimit arriti në 147 milionë euro, kryesisht si rezultat i investimeve në infrastrukturë.

D. Karakteristikat kryesore të stokut të investimeve të huaja direkte në Shqipëri

1. Stoku i IHD-ve sipas formës

Sipas një sondazhi të Bankës së Shqipërisë (BSH) për sipërmarrjet e investimeve të huaja (Kutia I.4), në vitin 2009, stoku i IHD-ve hyrëse në Shqipëri arriti në afërsisht 2.7 miliardë euro, ndërsa stoku i IHD-ve dalëse vetëm në 131 milionë euro (tabela 1.9). Midis filialeve të huaja në Shqipëri që morrën pjesë në sondazh_in e organizuar nga Banka e Shqipërisë, 78% e tyre janë me shumicë të zotëruara. Përsa i takon madhësisë së kompanive, 28% janë të vogla dhe 22% të mesme. 66% e kompanive janë të përqëndruara në Shqipërinë Qendrore, ndërsa pjesa tjetër është e shpërndarë në prefektura të tjera të vendit në përqindje thujse të barabarta.

Kutia I.4. Mbledhja e të dhënave mbi IHD-të dhe aktivitetin e shoqërive shumëkombëshe në Shqipëri

Të dhënat mbi fluksin dhe stokun e IHD-ve për Shqipërinë janë marrë nga sondazhi vjetor i Bankës së Shqipërisë për kompanitë, të cilat kanë së paku 10% pronësi të huaj. Sipas regjistrimit statistikor të vitit 2009 të prodhuar nga Instituti shqiptar i Statistikave (INSTAT), në Shqipëri ekzistonin 1700 sipërmarrje aktive të investimeve të huaja. Banka e Shqipërisë kontaktoi me këto kompani, përmes kanaleve të ndryshme për mbledhjen e të dhënave mbi investimet e huaja direkte. Një e treta e kompanive, kryesisht e atyre të mëdha ofruan të dhëna në lidhje me investimet e huaja. Rezultatet i bënë të mundur Bankës të Shqipërisë të azhurnonte statistikën në lidhje me fluksin e IHD-ve dhe të gjeneronte të dhëna mbi stokun e tyre, sipas karakteristikave të ndryshme strukturore. Paralelisht me sondazhin e Bankës së Shqipërisë, INSTAT-i organizon një sondazh strukturor mbi biznesin (SBS), i cili mbulon të gjitha kompanitë aktive në vend. Nga të dhënat e këtij sondazhi, INSTAT-i nxjerr të dhëna për shumicën e kompanive me pronësi të huaj, për të gjeneruar statistika në lidhje me karakteristikat e filialeve të huaja, të cilat shqyrtohen më poshtë (seksioni E).

Burimi: Banka e Shqipërisë

Të dhënat për stokun e IHD-ve regjistrohen në dy forma: kapital aksioner dhe fitime të ri-investuara (të kombinuara) dhe kapital tjetër (kryesisht huatë brenda kompanisë). Zëri “kapital aksioner dhe fitime të ri-investuara” përbën edhe pjesën më të madhe të stokut të IHD-ve në Shqipëri – 97% në fund të vitit 2009. Stoku i investimeve direkte dalëse gjithashtu përbëhej kryesisht nga “kapital aksioner dhe fitime të ri-investuara”.

Table I.9. Komponentët e stokut të IHD-ve hyrëse dhe dalëse, Shqipëri, 2003-2008

Komponentet e HDI-ve	(Millions of euro)						
	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009 ^a
Stoku i HDI-ve Hyrëse	357	612	846	1 054	1 688	1 986	2 692
Kapitali i investimeve dhe fitimet e ri-investuara	352	603	806	982	1 622	1 858	2 603
Kapital tjetër	5	9	40	72	67	128	89
Stoku i HDI-ve Dalese	..	8	8	31	51	105	131
Kapitali i investimeve dhe fitimet e ri-investuara	..	8	8	31	51	103	127
Kapital tjetër	..	-	-	-	-	2	4

Burimi: UNCTAD FDI/TNC baza e të dhënave (www.unctad.org/fdistatistics) bazuar në Bankes e Shqiperise.

^a Të dhënat për 2009 janë parashikime

Rritja e stokut të IHD-ve në vend në vitin 2008 ishte rezultat i transaksioneve të investimeve, ndryshimeve në kursin e këmbimit dhe rregullimeve të tjera (Tabela I.10).

Tabela I.10 Stoku i IHD-ve hyrëse si % e GDP-së në Shqipëri dhe % e vendeve të tjera të Europës Juglindore, 2004-2009

Country	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Shqipëria	11	12	15	23	21	29
Bosnje Hercegovina	28	28	34	45	40	46
Kroacia	31	33	56	77	46	58
Mali i Zi	11	29	51	69	72	110
Serbia	17	22	34	33	40	49
FYROM	41	36	43	47	47	52

Burimi: UNCTAD, WIR10, tabelat e anekseve

Shqipëria ka stokun më të ulët të investimeve të huaja direkte përkundrejt GDP-së midis vendeve të Evropës Juglindore (tabela 1.10). Kjo për faktin së investimet e huaja direkte në Shqipëri janë një fenomen i kohëve të fundit dhe pjesa më e madhe e stokut është akumuluar vetëm gjatë disa viteve të fundit. Gjithashtu, Shqipëria ka njohur rritje më të shpejtë ekonomike në vitet e fundit sesa fqinjët e saj të rajonit.

Tabela I.11. Perberja e ndryshimit të stokut të IHD-ve Hyrese dhe Dalese, 2007-2008^a
(Milione euro)

Stoku i IHD-ve	Pozicioni në fund te 2007-es	Transaksionet	Ndryshime ne Cmim	Ndryshime ne Kursin e Kembimit	Rregullime te tjera	Pozicioni ne fund te 2008-es
Investimet Direkte ne Ekonomine Raportuese	1688	675	1	-73	-305	1986
Kapitali Aksioner dhe fitimet e ri-investuara	1622	612	1	-72	-305	1858
Kapital tjetër	67	63	..	-2	128
Investimet Direkte Jashte vendit	51	56	..	-2	105
Kapitali Aksioner dhe fitimet e ri-investuara	51	54	..	-1	103
Kapital tjetër	..	2	2

Burimi: sipas Bankes se Shqiperise

^a Te dhenat e perberjes se ndryshimit te stokut te IHD-ve nuk jane akoma te mundesuar per 2009.

2. Stoku i IHD-ve Hyrëse në Shqipëri, sipas aktiviteteve kryesore ekonomike

Në vitin 2008, vetëm 16% e stokut të IHD-ve në Shqipëri ishte në sektorin e manufakturës (figura I.7 dhe tabela I.12), më pak se në vendet e tjera të Evropës Juglindore dhe akoma më pak se në shumicën e vendeve të reja anëtare të Bashkimit Evropian. Shumica e këtyre investimeve të huaja direkte është në industrinë e rëndë bazë (materiale ndërtimi, metale), ndërsa pjesa më e sofistikuar, e prodhimit mungon jo vetëm në sektorin e ndërmarrjeve të huaja, por edhe në atë vendas. Sektori i ndërtimit, me 15% të stokut të IHD-ve hyrëse është pothuajse po aq i rëndësishëm sa manufaktura. Lulëzimi i ndërtimit i financuar kryesisht nga të ardhurat e emigracionit (remitancat) coi në një lulëzim të ndërtimeve rezidenciale (të banesave) gjatë periudhës midis viteve 2004-2008.


Shërbimet zënë përqindjen më të madhe të stokut të IHD-ve në Shqipëri (figura I.6, pjesa E). Ndër to, aktivitetet e tregtisë së shumicës dhe pakicës ende zënë një përqindje të ulët të investimeve të huaja direkte, me vetëm 7% të totalit të stokut në vitin 2008. Kjo për faktin se ende nuk ishin hapur rrjetet e supermarkatave të mëdha të huaja në një shkallë të madhe në vend. Transporti, magazinimi dhe komunikimi zinin 23% të stokut të IHD-ve në vitin 2008, kryesisht për shkak të investimeve të huaja direkte në shërbimet e telefonisë fikse dhe asaj të lëvizshme. Por përqindja e tyre ra në vitin 2007 si pasojë e tërheqjes së disa investimeve.

Formatted: Not Highlight

Ndërmjetësimi financiar ka përbërë objektivin më të rëndësishëm të IHD-ve, me një të tretën e stokut në vitin 2008. Privatizimi, pothuajse i të gjithë industrisë bankare nga bankat dhe investitorët e huaj ka rezultuar në një fluks të madh kapitali përmes të cilit bankat janë ristrukturuar dhe kanë zgjeruar aktivitetin e kredisë.

Pavarësisht potencialit të mirë natyror për tërheqjen e turizimit, industria e hotelerisë dhe restoranteve zë vetëm 1% të stokut të IHD-ve. Dhënia me qera e pronave të paluajtshme dhe shërbime të tjera biznesi janë gjithashtu të nën-përfaqësuar në kuadrin e stokut të IHD-ve të vendit, në krahasim me vende më të zhvilluara, por gjithësesi zënë një përqindje më të lartë sesa në disa vende të tjera të rajonit. Për më tepër, shumë pak investime ka në shërbimet juridike dhe të konsulencës, prania e të cilave do të ishte e nevojshme për investitorët. Investimet e huaja direkte në këto shërbime mund të zgjerohen teksa rritet edhe kërkesa për to.

Figura I.7. Shqipëria: Stoku i IHD-ve hyrëse sipas aktivitetit ekonomik. 2007-2008



Burimi: sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë

Tabela.12 Shqipëria: Nr i projekteve të investimeve dhe stoku i IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik, 2007-2008
(Nr. milione euro dhe %)

Kategoria NACE ^a	Sektori/Industria	Nr projekt investimeve	2007		2008	
			Stoku IHD	%	Stoku IHD	%
	Primare	21	15	1	-29	-1
A	Bujqesi, gjueti & pyje	7	6	0	11	1
B	Peshkim	3	0	0	-59	-3
C	Miniera & gurrore	11	9	1	19	1
D	Manifakture	225	224	13	321	16
	Sherbime	316	1451	86	1696	85
E	Energji elektr., gaz & furnizim me uje	6	1	0	3	0
F	Ndertim	49	136	8	306	15
	Tregti shumice & pakice, riparim automjet.					
G		155	84	5	140	7
H	Hotele & restorante	7	20	1	19	1
I	Transport, magazinim & komunikim	23	588	35	467	23
J	Ndërmjetësim financiar	22	551	33	663	33
K	Pasuri e paluajtshme. qera, dhe aktivitetet e biznesit.	37	56	3	79	4
	Administrata publike & mbrojtje sigurime detyruar shoqerore	0	0	0	0	0
L		0	0	0	0	0
M	Arsim	4	2	0	2	0
N	Shendetesi & pune sociale	4	0	0	-1	0
	Sherbime te tjera komunitare, sociale dhe personale	9	13	1	18	1
O		9	13	1	18	1
Total		562	1,688	100	1,986	100

^a Burimi : Te dhenat sipas BSH

^a Klasifikimi i pergjithshem industrial i aktiviteve ekonomike ne komunitetin Evropian (Nomenclature Générale des Activités Économiques dans Communautés Européennes).

Rritja e stokut të IHD-ve në vitin 2008 u shoqërua me një ndryshim të strukturës së tij. Stoku në ndërtim u dyfishua në krahasim me vitin pararendës, duke dyfishuar në të njëjtën kohë përqindjen e vet në totalin e stokut, ndërsa ai i prodhimit u zgjerua me 43%, duke sjellë një rritje të vogël (3%) të përqindjes së tij. Transporti, magazinimi dhe komunikacioni pësuan një rënie me 21% të stokut të IHD-ve, ndërsa stoku në ndërmjetësimin financiar u rrit me 20%, për të ruajtur përqindjen e tij në totalin e stokut në pothuajse të njëjtin nivel me atë të vitit 2007 (tabela I.12).

3. Stoku i Investimeve të huaja direkte në Shqipëri, sipas vendit investues


Sic ndodh rëndom me vendet e vogla, Shqipëria merr një pjesë jashtëzakonisht të lartë të investimeve të saj të huaja direkte nga një vend fqinj – në këtë rast nga Greqia (tabela I.13 dhe figura I.8). Në vitin 2008, investimet e huaja direkte nga Greqia zinin 41% të stokut të IHD-ve, me gjashtë pikë përqindjeje më pak sesa në vitin pararendës. Megjithatë, vetëm 26% e investitorëve në Shqipëri vinin nga Greqia, gjë që flet për një përqëndrim të IHD-ve greke dhe fokusin e tyre në aktivitetet me intensitet kapitali. Investimet greke në Shqipëri janë kryesisht në fushën e telekomunikacionit (61%) dhe ndërmjetësimit financiar (22%). Edhe në rastin e investimeve të huaja direkte në industrinë financiare, Greqia mbetet vendi më i rëndësishëm i origjinës së investimeve të huaja direkte.

Tabela I.13. Stoku i IHD-ve në Shqipëri, sipas rajonit dhe vendit të origjinës, 2004-2008

	(%)				
Vendi i origjines/rajoni	2004	2005	2006	2007	2008
Vende te zhvilluara	87	85	88	85	81
Bashkimi Evropian	78	78	79	72	66
Austria	6	5	9	9	9
Gjermania	2	3	3	2	3
Greqia	56	55	53	47	41
Italia	13	12	11	11	8
Amerika e Veriut	5	6	7	11	13
SHBA	5	4	4	11	12
Vende ne zhvillim	10	12	10	14	18
Afrika	1	0	0	0	0
Amerika e Jugut & Karaibet	-	-	-	-	-
Azia & Oqeania	9	12	10	14	17
Libani	1	3	2	2	2
Turqia	4	6	6	11	14
Ekonomite ne tranzicion	3	3	2	1	1
Evropa Juglindore	3	3	2	1	1
Organizata Nderkombetare	3	0	0	1	2

Burimi : Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë

Figura I.8. Shqipëria: ndarja gjeografike e stokut të IHD-ve hyrëse, sipas burimit, 2008



Burimi: Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë.

Në vendin e dytë në renditje për sa i takon burimit të investimeve të huaja direkte në Shqipëri gjatë viteve 2007 dhe 2008 renditet Turqia me 14% të stokut në vitin 2008, me një rritje prej 3% në krahasim me vitin pararendës (tabela I.13). Në Shqipëri ka 40 kompani investitore turke, ku investimet e huaja direkte janë të përqëndruara në aktivitetet jo-financiare.

Shtetet e Bashkuara renditen të tretat për nga rëndësia si vend i origjinës për investimet e huaja direkte, duke zënë 12% të stokut të IHD-ve në Shqipëri në vitin 2008, dicka më lart se një vit më parë (tabela I.13). Shtetet e Bashkuara rrallë janë ndër burimet kryesore të investimeve të huaja direkte në vendet e rajonit. Në vitin 2004, Shtetet e Bashkuara renditeshin vetëm në vendin e shtatë përta i takon vendeve të burimit të IHD-ve në Shqipëri, me afërsisht 2% të stokut të IHD-ve hyrëse. Asnjë nga investitorët amerikanë nuk renditet ndër 10 kompanitë kryesore që investojnë në Shqipëri, me përjashtim të një fondi privat investimesh, Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve që ka investuar në disa projekte duke përfshirë në Bankën Amerikane të Shqipërisë, e cila në vitin 2008 u shkri dhe u bë pjesë e Bankës Intesa San Paolo nga Italia.

Austria zë vendin e katërt si vend i origjinës për investimet e huaja direkte në Shqipëri, me 9% të stokut të IHD-ve hyrëse në vitin 2008 (tabela I.13). Pothuajse të gjitha investimet austriake janë të përqëndruara në sektorin bankar, kryesisht si rezultat i blerjes të Bankës shqiptare të Kursimeve nga Banka Raiffeisen International, e cila do të shndërrohej në bankën më të madhe në Shqipëri, me 30% të aseteve bankare të vendit.


Tjetra në rradhë për nga rëndësia si vend i origjinës për investimet e huaja direkte vjen Italia, me 8% të stokut të IHD-ve hyrëse në vitin 2008, një përqindje kjo më e ulët nga një vit më parë, kur Italia ende vazhdonte të mbante 11% (tabela I.13). Investimet italiane janë të përqëndruara kryesisht në prodhim dhe ndërtim. Sigurisht që ato janë të pranishme edhe në sektorin e shërbimeve, kryesisht përta i takon ndërmjetësimit financiar, por gjithësesi financat nuk janë ende sic duhet të përfaqësuara në investimet e huaja italiane direkte në Shqipëri, në krahasim me investimet e huaja direkte nga vendet e tjera që janë investitore kryesore. Një tipar tjetër i vecantë i investimeve italiane është që ato janë të shpërndara ndërmjet një numri të madh kompanish: 42.5% e 546 investitorëve vijnë nga Italia. Rënia e investimeve italiane në terma relative është edhe më mbresëlënëse po të krahasohet me vitin 2004, kur ajo ishte e dyta për nga rëndësia pas Greqisë, me 30% të stokut të IHD-ve hyrëse në Shqipëri.

Të pesta vendet e lartpërmendura bashkarisht përgjigjen për 84% të stokut së investimeve të huaja direkte dhe përfaqësojnë 80% të filialeve të huaja në Shqipëri. Vecanti të tjera përtej një përfaqësimi të lartë të Greqisë, ku vendin e dytë dhe të tretë e mbajnë përkatësisht Turqia dhe SHBA-ja në stokut e IHD-ve në Shqipëri, përbën edhe fakti i një përfaqësimi të ulët të investitorëve nga Gjermania, e cila rëndom renditet midis pesë më të rëndësishme të origjinës për investime të huaja direkte në vende të Evropës Qendrore dhe Lindore. Prania e kufizuar e investimeve të huaja direkte gjermane në Shqipëri mund të jetë si pasojë e mungesës relative të mundësive për investim në manufakturë.

E. Efektet e investimeve të huaja direkte: roli i filialeve të huaja në ekonominë shqiptare

Ky seksion hedh dritë mbi disa prej karakteristikave të rëndësishme të ndërmarrjeve me shumicë pronësie të huaj (filialet e huaja), dhe synon të kuptojmë më mirë kontributin e tyre në ekonominë shqiptare. Dallimi kryesor ka të bëjë me përqindjen minimale të pronësisë së huaj të ndërmarrjeve në fjalë, që është 10% sipas statistikave për investimet e huaja direkte të Bankës së Shqipërisë dhe 50% sipas statistikave të INSTAT-it për filialet e huaja (FATS) (sipas përkufizimit të Eurostat-it). Gjithashtu, burimi i të dhënave për ndërmarrjet është pjesërisht i ndryshëm, por si sondazhi i Bankës së Shqipërisë, ashtu edhe ai i INSTAT-it (Kutia 1.4) mbulojnë ndërmarrjet kryesore të huaja të investimeve. Të dhënat janë të grupuara sipas aktiviteteve ekonomike, në përputhje me NACE –n (*Nomenclature Générale des Activités Économiques dans les Communautés Européennes*) në nivel dy shifror. Megjithatë, mbulesimi sipas aktivitetit ekonomik është vetëm i pjesshem dhe përjashton ndërmarrjet që janë aktive në ndërmjetësim financiar, arsim, shëndetësi dhe veprimtari kulturore. Të dhënat e SBS-së dhe FATS-it u referohen vitit 2008 dhe mund të bëhet një krahasim me vitin 2007, vit për të cilin disponohen të dhëna të ngjashme. Sondazhet e INSTAT-it mbulojnë 512 filiale të huaja për vitin 2008 dhe 405 për vitin 2007. Të dhënat e FATS-it janë peshuar në të njëjtën mënyrë si të dhënat e tjera të SBS-së, duke siguruar kështu krahasueshmëri që lejon llogaritjen e përqindjes së filialeve të huaja në ekonominë shqiptare sipas treguesëve të ndryshëm të SBS-së.

Figura I.9. Pjesa e filialeve të huaja në ekonominë shqiptare^a sipas treguesve të ndryshëm, 2008 (në përqindje)



Burimi: Sipas INSTAT-it, anketime strukturore të biznesit -Shqipëria (SBS)

^a Me përjashtim të ndërmjetësimit financiar, arsimit, shëndetësisë dhe veprimtarive kulturore.

Numri i filialeve të huaja është i parëndësishëm në krahasim me numrin përgjithshëm të ndërmarrjeve; vetëm 1.2% e gjithë numrit të ndërmarrjeve aktive në Shqipëri është me shumicë pronësie të huaj (figura I.9, tabela I.14). Aksionet e huaja janë më të mëdha në manufakturë (4%) dhe shumë të ulëta në disa shërbime. Megjithatë, në aktivitetet ku numri i ndërmarrjeve është gjithësesi i vogël, më shumë se gjysma e tyre janë filiale të huaja: në nxjerrje naftë, industrinë e duhanit, makineri elektrike dhe transportin ajror. Këto janë

Formatted: Not Highlight

Formatted: Not Highlight

aktivitete me një intensitet shumë të lartë kapitali dhe ku ndërmarjet e vogla dhe të mesme, me pronësi vendase/lokale zakonisht janë të ralla. Në aktivitete të tjera, si tregtia e pakicës apo hotelet dhe restorantet, NMV(Ndërmarjet e vogla dhe të Mesme)-të vendase janë të shumta dhe kanë pozicion dominues .

Formatted: Not Highlight

Tabela I.14. % e filialeve te huaja ne ekonomine shqiptare sipas industrive Tregues te ndryshem, 2008

Industria	Numri I			Totali I pagave	Vlera e shtuar	Totali I Investimeve
	Numri I Kompanive	personave te punesuar	Te ardhurat			
5 Peshkimi	1.4	8	7.9	14.5	8	8
11 Nxjerrja e Naftes	75	9.5	53.5	10.9	45.7	100
13 Nxjerrja e Mineral Metaleve	2.3	17.8	36.5	29	41.7	87.7
14 te tjera nxjerrje dhe germime	2.1	12.2	10	23.6	15.6	0
15 Ushqime	0.6	16.3	30.8	27.7	14.5	27.6
16 Cigare	66.7	98	100	97.4	97.5	0
17 Tekstile	3	31.5	25.7	50.9	31.6	44.8
18 Veshmbathje	16.6	60.8	55.1	62.4	59.4	62.4
19 Lekure	41.5	59.3	62.1	60.5	57.4	49.2
20 Druri	1.4	8.9	9.5	13.3	7.2	59.7
21 Leter	20.5	28.7	12.3	26.9	13.8	0.1
22 Publikime	2.4	8	10.4	10.4	9.2	8.9
23 Prodhime te Naftes	7.3	13.1	18.7	14.7	19.6	52.7
25 Gome dhe Plastike	10.5	58.4	58.6	58.5	61.7	56.1
26 Minerale jo-metalesh	4	37.6	59.2	64.9	67.9	72.3
27 Minerale bazike	7.4	89	95	95	94.8	93.7
28 Minerale te fabrikuara	1	19.7	25.1	35	25	8.4
29 Makineri n.e.c	21.6	5.1	19.2	14	17.7	5.6
31 Makineri elektrike	57.5	89	79.4	88.8	87	84.2
33 Instrumente mjeksore	4.8	8.6	4.2	13.8	4.2	11.9
35 Pajisje te tjera transporti	37.5	52.6	57.4	54.3	52.1	0.5
36 Prodhimi n.e.c	2.6	27.3	33.5	41.5	40.2	9.4
37 Riciklimi	4	16	3.9	18.6	10.7	34.9
40 Elektriciteti,gazi	25.6	0.2	0.8	1.6	2.4	1.4
41 Uje	1.7	3.3	6.3	4.5	1.8	6.9
45 Ndertimi	2.1	16	34.2	43.2	41.3	41.3
50 Shitja e automjeteve	1.7	3.9	10.7	11.8	4.6	21.8
51 Shitje me shumice	5.4	11	15	17.2	6.2	27.8
52 Shitje me pakice	0.1	0.6	3.6	4.4	2.5	35.2
55 Hotele dhe restorante	0.1	2.4	6.6	10.3	8.6	23.9
60 Transport tokesor	0.1	0.9	3.7	2.8	8.8	11.5
61 Transport ujqor	9.4	7	1.2	8.3	3.4	0.3
62 Transport ajror	50	75.4	14.3	32		0
63 Transporte te tjera	2.8	12.1	25.8	18.8	29.5	2.3
64 Posta dhe telekomunikacioni	3.9	50.5	92.8	61.7	93.2	89.2
70 Aktivitete te Pasurive te Paluajtsh	12.4	11.4	27.3	16	32.4	12.8
71 Qeradhenia	10	24.1	4.4	37.1		0
74 Aktivitete te tjera biznesi	2.1	6.2	29.2	21.4	15	17
90 Perpunim Mbeturinash	5.3	3.9	9.7	3.5		1
93 Sherbime te tjera	0.1	0.8	1.4	3.7	1.5	29.8
Te gjitha Industrite	1.2	16	26.7	30.6	38.7	41.3
Prodhimi	4	42.3	50.2	54	52.2	49.2


Burimi: sipas INSTAT, statistikat e strukturimit te biznesit

a Perjashtohen aktivitet qe lidhen me Ndermjetesimin Financiar, Arsimin,Shendetesine dhe Kulturen.

Përçindja e filialeve të huaja në ekonominë shqiptare është shumë më e lartë sipas të gjithë treguesëve, me përjashtim të numrit të ndërmarrjeve (tabela I.15, figura I.9). Kjo tregon se filialet e huaja janë të një shkalle të madhe persa i takon madhësisë së tyre, ato kanë shumë më shumë të punësuar dhe xhiro për ndërmarrje në krahasim me kompanitë me pronësi vendase.

Shpërndarja e filialeve të huaja sipas sektorëve të ekonomisë (figura I.10) është e ndryshme nga struktura e ndërmarrjeve shqiptare. Karakteristika kryesore dalluese është përçindja e lartë e kompanive të përfshira në sektorin e prodhim (57%), pavarësisht nga një përçindje e vogël kundrejt totalit të stokut të IHD-ve (16%) (tabela I.12) si dhe tregëtisë (16%).

Figura I.10. Shpërndarja e filialeve të huaja në Shqipëri, sipas aktivitetit ekonomik^a, 2008 (në përçindje)



Burimi: Sipas INSTAT-it, anketimi strukturor i biznesit -Shqipëria (SBS)

^a Me përjashtim të ndërmjetësimit financiar, arsimit, shëndetësisë dhe veprimtarive kulturore.

Një ndër treguesit më të rëndësishëm të rolit të sektorit të huaj jo-financiar është pjesa që ai zë në vlerën e shtuar në sektorët ekonomikë jo-financiarë të vendit. Me pothuajse 39% të totalit, sektori i huaj jep një kontribut shumë të rëndësishëm në vlerën e shtuar. Në prodhim, filialet e huaja kontribuojnë pjesën kryesore, 52%. Të dyja përçindjet janë rritur në krahasim me vitin 2007. Me fjalë të tjera, Shqipëria po kalon përmes një procesi ri-industrializimi të bazuar tek investimet e huaja. Aktualisht, i gjithë sektori i prodhimit është ende shumë i dobët dhe struktura e tij dominohet nga aktivitete të një teknologjie të ulët.


Nga 22 aktivitete prodhimi, filialet e huaja kanë një pozicion mbizotërues në prodhimin e vlerës së shtuar në tetë industri (tabela I.14). Ato përfshijnë industrinë që punësojnë një numër të lartë të fuqisë punëtore si p.sh. prodhim veshmbathjesh dhe artikuj lëkure, si edhe industrinë që përdorin një sasi të madhe kapitali si: prodhimi i mineraleve jo metalore (duke përfshirë materialet e ndërtimit) dhe produkte bazë metali. Këto katër industri janë aktivitete prodhuese më të rëndësishme të investitorëve të huaj, me 80% të vlerës së shtuar në prodhimin nga filialet e huaja.

Në industrinë e tjera, filialet e huaja dominojnë vlerën e shtuar vetëm në telekomunikacion. Ato kanë gjithashtu një rol të rëndësishëm me afërsisht 40% të vlerës së shtuar në miniera dhe ndërtim. Këto janë gjithashtu aktivitetet që kanë një përqindje të lartë në stokun e investimeve të huaja direkte. Përsa i takon industrive më të sofistikuar të prodhimit, përqindjet e ulëta të kapitalit të huaj në vlerën e shtuar, si edhe në stokun e investimeve të huaja direkte flasin për të njëjtën tendencë, pra, nevojën për tërheqjen e investitorëve të huaj. Tashmë ekzistojnë dy aktivitete të tilla me një prani të rëndësishme të investimeve të huaja: prodhimi i makinerive elektrike dhe i mjeteve të transportit, të ndryshme nga automjetet . Në këto industri, filialet e huaja kanë një përqindje të lartë, por në një industri të vogël.

Xhiroja e filialeve të huaja përfaqëson 27% të totalit, ndërsa në industrinë e manufakturës kjo shifër është 50%. Industrinë kryesore me përfshirjen më të lartë të kompanive të huaja janë të njëjtat si ato të vlerës së shtuar. Xhiroja e filialeve të huaja sigurohet nga katër aktivitete ekonomike kryesore: industria (30%), transporti dhe telekomunikacionet (26%), ndërtim (22%) dhe tregëti (20%) (figura I.11).

Në krahasim me vitin 2007, xhiroja e filialeve të huaja në vitin 2008 ishte 50% më e lartë në cmime nominale (41% në terma reale, me deflatim nga indeksi i cmimit të prodhuesit). Rritja ishte mbi mesataren në ndërtim dhe manufakturë. Në prodhim, xhiroja e filialeve të huaja pothuajse mbeti e pandryshuar në sektorin e tekstileve, veshmbathjeve dhe artikujve të lëkurës, ndërsa pati një lulëzim të prodhimit të mineraleve jo metalore. Ndonësi zhvillimi industrial ka qënë në vija të përgjithshme mbresëlënëse, nuk ka patur ndonjë kalim drejt industrive të orientuara drejt eksportit. Lulëzimi i sektorit të ndërtimit përbënte motorin kryesor të rritjes, duke ndikuar tek minierat dhe guoret, e rrjedhimisht tek materialet e ndërtimit, prodhimin e produkteve minerare jo-metalike dhe të lëndës së drurit dhe metaleve. Rritja ekonomike mori një stimul më të madh nga privatizimi i komunikacionit dhe investimet e huaja në industrinë e naftës.

Figura I.11. Shqipëria: Xhiroja e filialeve të huaja sipas aktivitetit ekonomik ^a, viti 2008 (në përqind)




Burimi: Sipas INSTAT-it, anketimi strukturor i biznesit -Shqipëria (SBS)
^a me përjashtim të ndërmjetësimit financiar, arsimit, shëndetësisë dhe aktiviteteve kulturore.

Përsa i përket **punësimit**, filialet e huaja përgjigjen për 16% të punësimit për ekonominë në tërësi, por shumë më shumë, 42% për punësimin në sektorin e prodhimit. Përqindja e punësimit është relativisht e ulët në krahasim me xhiron apo vlerën e shtuar, që është shenjë e një produktiviteti më të lartë të krahut të punës të sektorit të huaj në krahasim me atë vendas. Hendeku i produktivitetit është shumë më i vogël në prodhim sesa në aktivitete të tjera. Krahasimi sektorëve industriale, duke marrë në konsideratë përqindjet e punësimit dhe xhiros tregon se në cilet sektore produktiviteti i krahut të punës së filialeve të huaja është më i lartë (përqindje më e lartë xhiroje sesa punësimi) sesa mesatarja e ekonomisë (figura I.12). Përsa i takon industrisë së lehtë dhe prodhimit të makinerive elektrike, filialet e huaja kanë produktivitet të njëjtë ose më të ulët të krahut të punës në krahasim me mesataren. Në këto aktivitete, kompanitë si vendase, ashtu edhe ato të huaja varen nga teknologji të ngjashme që punësojnë një numër të konsiderueshëm të krahut të punës. Sektori i huaj është më me peshë përsa i takon produktivitetit të krahut të punës në aktivitete industrial që kërkojnë një nivel të lartë kapitali si mineralet jo-metalike, metalet bazë dhe makineri të përgjithshme.

Formatted: Not Highlight

Figura I.12. Përqindja e filialeve të huaja në prodhim në Shqipëri, sipas industrive, tregues të përzgjedhur, viti 2008




Burimi: Sipas INSTAT-it, anketimi strukturor i biznesit -Shqipëria (SBS)

Aktiviteti i **investimeve** të filialeve të huaja mbërrin në 41% të totalit të investimeve në sektorin e biznesit jo-financiar (tabela I.14). Shpenzimet e investimeve për njësi të vlerës së shtuar dhe xhiroja janë më të larta në sektorin e huaj sesa mesatarja e ekonomisë shqiptare. Shtimi i investimeve falë një tendence më të madhe të kompanive të huaja për të investuar në aktivitetet që kërkojnë investime më të mëdha është një avantazh i qartë që përfitohet nga investimet e huaja direkte. Investimet janë në vecanti të larta në sektorin e telekomunikacioneve pas privatizimit nga kompani të huaja; ato janë relativisht të pakta në manufakturë.

|

Figura I.13. Përqindja e filialeve të huaja në vlerën e shtuar dhe në punësim, Shqipëria dhe ekonomi të tjera të përzgjedhura evropiane^{a, b}, viti 2006



Burimi: Sipas EUROSTAT-it dhe INSTAT-it, anketimi strukturor ibiznesit (SBS).

^a me përjashtim të ndërmjetësimit financiar, arsimit, shëndetësisë dhe aktiviteteve kulturore.

^b Të dhënat për Shqipërinë janë për vitin 2008, ndërsa për Bullgarinë për vitin 2005.

Shqipëria është ndër vendet me penetrimin më të lartë të huaj në Evropë. Disponohen krahasime ndërkombëtare nga Statistikat Standarde të Biznesit të Eurostat-it për tregues si: vlera e shtuar dhe punësimi në filialet e huaja për vitin 2006.⁶ Ndërsa viti i referimit është ndryshe. Përqindja e filialeve të huaja në vlerën e shtuar në Shqipëri (2008) renditet në vendin e katërt afër kreut, pranë vendeve me përqindjet më të larta si: Republika Çeke, Estonia dhe Sllovakia. Vetëm Hungaria, që është vendi lider në Evropë është shumë përpara Shqipërisë. Përsa i takon punësimin në filialet e huaja, Shqipëria renditet në vend të gjashtë, në mënyrë të ngjashme me Hungarinë dhe pas vendeve si Estonia apo Sllovakia. Në vendet ku ekziston një hendek i madh midis vlerës së shtuar dhe punësimin, filialet e huaja kanë një produktivitet shumë më të lartë të krahut të punës sesa pjesa tjetër e ekonomisë. Ky është rasti i Shqipërisë dhe Hungarisë dhe mund të jetë tregues i ndikimit të dobët nga sektori i huaj drej atij vendas. Në vendet ku të dy përqindjet janë afër njëra-tjetrës (si Estonia), hendeku midis produktivitetit të krahut të punës të filialeve të huaja dhe kompanive vendase është i ngjashëm gjë që mund të jetë tregues i ndikimit të fortë. (Görg H dhe Greenaway, D.2001)

Përqindja e filialeve të huaja është zakonisht më e lartë në industri, sesa në aktivitete të tjera. Sllovakia dhe Hungaria kanë përqindjen më të lartë të filialeve të huaja në Evropë në


⁶ EUROSTAT, Sipërmarrjet e kontrolluara nga kompani të huaja në BE, botimi Statistics in Focus, 30/2008

Formatted: English (United States)

Formatted: English (United States)

raport me vlerën e shtuar, përkatësisht me 60% dhe 53%. Shqipëria renditet në vend të katërt me 44%.

Figura I.14. Përqindja e filialeve të huaja në vlerën e shtuar në industri, vende të përzgjedhura, viti 2006 (në përqindje)



Burimi: Sipas EUROSTAT-it dhe INSTAT, anketimi strukturor i biznesit (SBS).

Si konkluzion,

- Filialet e huaja kanë rëndësi të madhe për ekonominë shqiptare në lidhje me vlerën e shtuar, prodhimin, punësimin dhe aktivitetin e investimeve.
- Shkalla e pjesëmarrjes së huaj në ekonomi është e ngjashme me atë të vendeve të Evropës Qendrore, që kanë treguesit më të lartë të pjesëmarrjes së investimeve të huaja direkte në Evropë.
- Pjesëmarrja e lartë e huaj në disa sektore është gjithashtu shenjë e dobësisë së kompanive vendase në hisen e tyre të ekonomisë, duke përfshirë edhe faktin që sektori i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare nuk është ende në nivelin e duhur të zhvillimit.
- Filialet e huaja në Shqipëri nuk janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në të gjithë ekonominë e vendit. Ndonëse ato janë përgjegjëse për ri-industrializmin në një farë shkalle të vendit, përfshirja dhe angazhimi i tyre në aktivitete me teknologji më të lartë është e kufizuar.
- Hendeku i produktivitetit të krahut të punës midis filialeve të huaja dhe kompanive vendase në Shqipëri është relativisht i vogël në industrinë e manufakturës, cka flet për një nivel afërsisht të njëjta teknologjik të përdorur në filialet e huaja.

KAPITULLI II. ROLI DHE NDIKIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË SHËRBIMET NË SHQIPËRI

Gjatë dy dekadave të fundit, Shqipëria është transformuar nga një ekonomi bujqësore në një ekonomi të dominuar nga shërbimet. Përqindja e bujqësisë ra nga mbi 50% që ishte shifra për vitin 1992, në 23% në vitin 2002, duke u ulur edhe më tej në 18% në vitin 2008 (tabela II.1). Njëkohësisht, ra edhe përqindja e industrisë me afërsisht 10% në vitin 2008, ndërsa ajo e ndërtimit u rrit në 14%. Pjesën tjetër të GDP-së, afërsisht 58% e zënë shërbimet (tabela II.1). Rritja e produktivitetit të shërbimeve spjegohet pjesërisht me rritjen në GDP-së dhe spostimin drejt i kërkesës për shërbime. Kjo erdhi pjesërisht si pasojë e hapjes së ekonomisë shqiptare dhe rritjes së importit bujqësor dhe të mallrave të manifakturës gje qe solli në vecanti në një rënie të prodhimit industrial. Shërbimet jo të tregtueshme mund të ofrohen vetëm duke u prodhuar aty ku gjenden edhe klientët dhe prodhimi i tyre duhet të rritet për të plotësuar kërkesat.

Largimi i prodhimit nga bujqësia drejt shërbimeve nuk u shoqërua plotësisht nga një kalim i ngjashëm strukturor në modelin e punësimit. Bujqësia përbën ende profesionin më të përhapur dhe përgjigjet për përqindjen më të lartë të punësimit, ndërsa shërbimet përfaqësojnë vetëm 38% të punësimit. Mospërputhja midis përqindjeve të prodhimit dhe punësimit vjen pjesërisht për shkak të mbivlerësimit të punësimit në bujqësi, ku e gjithë popullata mbi 16 vjec konsiderohet si e punësuar, por tregon gjithashtu që produktiviteti i ulët i krahut të punës në sektorin bujqësor shoqërohet nga një produktivitet relativisht më i lartë sesa në pjesën tjetër të ekonomisë, që dominohet nga shërbimet. Investimet e huaja direkte kanë qënë një forcë shtytëse e rritjes së rendimentit dhe prodhimtarisë në sektorët jo-bujqësorë.

Tabela II.1. Vlera e shtuar bruto sipas aktiviteteve ekonomike, viti 1992 dhe vitet 2001-2008.
(ne %)

	1992	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Industri	17	13	7	9	10	11	11	9	10
Bujqësi	54	34	23	24	22	21	20	19	18
Ndertim	8	10	12	12	14	14	14	15	14
Transport	3	10	7	5	5	5	5	5	5
Shërbime	18	33	51	50	49	49	50	52	53

Burimi : Të dhënat sipas INSTAT, Tiranë, Shqipëri.

Investimet e huaja direkte në shërbime mund të kenë ndikim pozitiv në sektorin e shërbimeve të një vendi pritës, duke sjellë kapital dhe transferuar njohuri, ekspertizë manaxheriale dhe aftësi profesionale që rrisin produktivitetin dhe prodhimin në atë vend. Përveç kësaj, investimet e huaja direkte mund të ndihmojnë në krijimin dhe futjen e shërbimeve të reja. Kompani që ofrojnë shërbime më konkurruese me një cilësi të lartë dhe me kosto më të ulëta sjellin përfitime për konsumatorët shqiptarë, si edhe për industrinë që i përdorin këto shërbime si inpute të ndërmjetme, duke kontribuar kështu në konkureshmërinë e ekonomisë në përgjithësi. Gjithashtu, kemi të bëjmë edhe me transferime të teknologjisë në rast se të punësuarit që i përftojnë këto aftësi profesionale, kur punësohen në ndërmarrje të huaja i shpërndajnë ato kur largohen nga kompanitë e huaja dhe u bashkohen kompanive shqiptare.

Në vitin 2008, investimet e huaja direkte në shërbime përbënin tre të katërtat e stokut së investimeve të huaja direkte për atë vit. Ekzistojnë dy lloj shërbimesh kryesore, telekomunikacione dhe ndërmjetësim financiar, të cilat janë me rëndësi të vecantë si përfituese të investimeve të huaja direkte, qe perllorariten respektivisht 23% dhe 33% të

totalit të stokut së IHD-ve në vend (figura I.7, tabela I.12). Zhvillimi i nxitur nga investimet e huaja direkte në këto shërbime merret në shqyrtim më me hollësi më poshtë. Sic theksohet në kapitullin e parë, shërbime të tjera si tregtia me shumicë dhe pakicë ende nuk ka tërhequr investitorë të huaj në një shkallë të madhe. Rrjetet evropiane të supermarkatave që dominojnë sektorin e pakicës në vendet e reja anëtare të Bashkimit Evropian ende nuk janë të përfaqësuar gjerësisht dhe thelbësisht në ekonominë e vendit. Përveç një dyqani shumice nga grupi METRO GROUP (Gjermani), supermarkata e prodhimeve ushqimore italiane “Conad” është firma më e rëndësishme e huaj që operon në shërbimet e tregtisë me shumicë dhe pakicë në Shqipëri, me disa pika te vogla dyqanesh në Tiranë. Aktivitetet e pasurisë së paluajtshme nga filialet e huaja janë gjithashtu insinjifikative dhe përbëjnë vetëm 0.7% të investimeve të huaja direkte. Vlen më shumë të përmenden zhvillimet në “aktivitete të tjera biznesi”, duke përfshirë konsulencën, shërbimet e informatikës (IT) dhe shërbimet e call-centres-, që në vitin 2008 zinin 3.3% të stokut të IHD-ve. Shërbimet e proceseve të biznesit dhe ato të teknologjisë së informacionit kanë evoluar në një farë mase, qe prej vitit 2007 dhe në këtë aspekt mund të ketë prespektive pozitive në krahasim edhe me vende të tjera të rajonit. Afërsia me Italinë dhe aftësitë e mira të shprehive gjuhësore në gjuhën italiane në një përqindje në rritje të popullatës shqiptare bëjnë të mundur që Shqipëria të tërheqë firma italiane për ngritjen e shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe call-centres. Ndër pionierët e këtij grupimi përfshihen dy kompani italiane: Answer Group dhe Teleperformance. Shtimi i trainimit të krahut të punës dhe shërbime më të mira të telefonisë fikse janë evidentuar si faktorë të një rëndësie të madhe për një rritje të mëtejshme të shërbimeve të biznesit.

Formatted: Not Highlight

A. Investimet e huaja direkte në shërbimet e telekomunikacionit

Telekomunikacionet përfaqësojnë një ndër aktivitetet më dinamike të shërbimeve në Shqipëri. Ato janë zhvilluar kryesisht përmes privatizimit dhe investimeve pasuese të investitorëve të huaj dhe në një farë mase edhe përmes investimeve vendase.

- Operatori i parë i telefonisë të lëvizshme në Shqipëri hyri në treg në vitin 1996 nga kompania shqiptare e telefonisë së lëvizshme, AMC, që asokohe ishte kompani shtetërore. Në vitin 2000, 85% e aksioneve të AMC-së u privatizuan për një shumë prej 85.6 milionë eurosh përmes shitjes së tyre tek konsorciumi Cosmote Telenor (Greqi). Pjesa e mbetur e aksioneve shtetërore prej 15% u privatizua në muajin mars të vitit 2009 për 48.2 milionë euro. Momentin e privatizimit të saj, kompania AMC numëronte 15,000 abonentë, ndërsa në vitin 2008 ajo numëronte afërsisht 1,400,000 abonentë, duke mbuluar rrjedhimisht 47.1% të industrisë së lëvizshme, duke punësuar afërsisht 500 persona.
- Vodafone Shqipëria ishte operatori i dytë që do të licensohej në Shqipëri në qershor të vitit 2001. Rrjeti GSM i kompanisë Vodafone mbulon 90.9% të territorit shqiptar dhe 99.6% të shqiptarëve në zonat rurale dhe urbane.
- Eagle Mobile, operatori më i ri në fushën e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri hyri në treg në muajin tetor të vitit 2008, duke punësuar 250 persona, ndërsa 150 persona të tjerë u punësuan në kompanitë nën-kontraktuese. Gjithashtu kontriboi në rritjen e madhe të numrit të abonenteve mobile për vitin 2009
- Në vitin 2009 mori licencën për të operuar në telefoninë e lëvizshme në tregun shqiptar operatori i katërt. Licenca iu shit për 7.5 milionë euro një shoqërie aksionere midis disa kompanive shqiptare dhe Postë Telekomunikacionit të Kosovës.

- Operatori i telefonisë fikse, Albtelekom sh.a, privatizoi 76% të aksioneve të tij për një shumë prej 120 milionë eurosh përmes shitjes tek grupi Calik Enerji Telekomunikasyon (Turkey), bashkë me partnerin e vet të Telekomit turk. Numri i përdoruesëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2008 ishte afërsisht 324,000, d.m.th 9% më i lartë se në vitin 2007.


Tabela II.2. Numri i përdoruesëve të telefonisë celulare dhe të asaj fikse Shqipëri, 2003-2009

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Fixed-line	243 858	256 266	273 056	289 637	296 146	323 964	363000
Mobile	1 099 611	1 259 195	1 530 244	1 909 885	2 323 436	2 964 473	4 163 624

Burimi: Të dhënat janë siguruar nga Autoriteti i Komunikacionit Elektronik dhe Postar (AKEP), Tiranë, Shqipëri

Midis periudhës 2005 dhe 2009, numri i lidhjeve të telefonisë fikse në Shqipëri u rrit me afro 30% në 363,000 abonentë, ndërsa për telefoninë e lëvizshme pothuajse u trefishua duke arritur mbi 4.16 milionë abonentë në vitin 2009 (tabela II.2). Ky nivel i penetrimit të telefonisë të lëvizshme është po aq i lartë sa edhe ai i vendeve të zhvilluara evropiane si psh Gjermania.

Figura II.1. Përqindjet e penetrimit të telefonisë fikse dhe asaj të lëvizshme, për vende të përzgjedhura (Numri i linjave për 100 banorë)



Burimi: OECD, “Indeksi i Reformës së Investimeve për Evropën Juglindore, Politikat e Monitorimit dhe Institucionet e Investimeve Direkte”, Prill 2010

Sipas vlerësimit më të fundit të Indeksit të Reformës të Investimeve të OECD-së (Prill 2010), përhapja e telefonisë fikse në Shqipëri mbetet më e ulëta në Evropën Juglindore, përkundrejt asaj të lëvizshme që është rritur me shpejtësi. Kjo situatë është tipike për

Formatted: Not Highlight

zhvillimin e telekomunikacionit në vendet ku popullata e gjerë ka përballjen e saj të parë me shërbimet e telefonisë në moshën e telefonisë celulare. Fakti që nivelet e ulëta të përdorimit të telefonisë fikse nuk janë çështje oferte, por kërkesë konfirmohet edhe nga koha e shkurtër e nevojshme për të pasur një lidhje të re – afërsisht shtatë ditë në Shqipëri në krahasim me 18 ditë në Bosnje- Hercegovinë dhe gjashtë ditë në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Malin e Zi (OECD, 2010). Megjithatë, cilësia e shërbimeve të ofruara nga infrastruktura e telekomunikacionit fikse, e matur me ndërprerjet dhe mangësitë për 100 linja kryesore është ndër më të ulëtat në rajon (OECD, 2010).


Densiteti i lidhjeve të internetit në Shqipëri është më i ulëti në rajon, 2.52 për 100 banorë, ndonëse me tendencë për tu rritur. Niveli i ulët i lidhjeve të telefonisë fikse e ka kufizuar aksesin në internet, por në të ardhmen aksesin në internet mund të përhapet gjithashtu përmes ofruesëve të internetit të lëvizshëm. Aktualisht, rritja dhe përhapja e shërbimeve call centers të teknologjisë së informacionit pengohet edhe nga mungesa e lidhjeve të mjaftueshme të telefonisë fikse.

B. Investimet e huaja direkte në shërbimet bankare

Ashtu si në vende të tjera të Evropës Juglindore, reformat e tregut në Shqipëri u përshpejtuan qysh nga fundi i viteve 90-të. Të gjitha vendet e rajonit kaluan përmes një ristrukturimi të sistemit të tyre bankar përmes privatizimit të bankave shtetërore, kryesisht nga banka të huaja. Transferimi i njohurive bankare dhe fondeve përmes këtyre investimeve të huaja ndihmoi në stabilizimin e sistemeve të tyre financiare. Në vitin 2008, financat ishin përfitueset kryesore të investimeve të huaja direkte, duke u përgjigjur për 32% të rezervës të investimeve të drejtuara nga brenda të rajonit (UNCTAD, WIR10, fq.52). Njëkohësisht, përqindja e aseteve bankare në pronësi të kompanive të huaja ishte rritur në 90%, si në Shqipëri, ashtu edhe në shumicën e vendeve të rajonit (figura II.2). Kjo përfaqëson një ekspozim më të lartë përkundrejt bankave të huaja sesa në vendet e reja anëtare të Bashkimit Evropian (BERZH, 2010).


Investitorët më të mëdhenj të rajonit, përfshirë Shqipërinë, janë nga Austria, Franca, Greqia dhe Italia. Në vitin 2009, bankat greke kishin kontrollin e afërsisht 15% deri 30% të tregut në disa vende të rajonit. Në përgjithësi, bankat e huaja duket të kenë patur influencë pozitive në lidhje me efikasitetin dhe stabilitetin e sistemit bankar në rajon. Ato kanë forcuar manaxhimin e riskut dhe qeverisjen e korporatave përmes një akordimi më efikas të kapitalit dhe rritjes së konkurrencës, si edhe kanë paraqitur shërbime më të sofistikuar financiare. Rrjedhimisht, industria bankare është zgjeruar me shpejtësi duke mbështetur rritjen ekonomike, ndërsa numri i huave të këqia në Shqipëri dhe në vendet e tjera të rajonit, te pakten deri në 2008, ka ardhur në rënie (figura II.3).

Figura II.2. Përqindja e bankave të huaja në totalin e aseteve bankare në vendet e Evropës Juglindore, 2002, 2008



Burimi: UNCTAD, WIR10.

Figura II.3. Huatë e këqia në vende të përzgjedhura të Evropës Juglindore, 2000–2008




Burimi: UNCTAD, 2010.

Kohët e fundit, efektet e krizës financiare ndërkombëtare përmes sistemit bankar i kanë shtuar shqetësimet në Shqipëri dhe në vende të tjera të Evropës Juglindore. Në Shqipëri, megjithatë, sektori bankar është në gjendje të mirë, jo vetëm falë privatizimit të tij dhe përfshirjes së bankave të huaja, por edhe falë politikave monetare që siguruan mbështetjen e duhur në kohë përmes dy shkurtimeve në përqindjen e interesit të Bankës Qendrore dhe injektimit të likuiditetit përmes kursit të këmbimit të vitit 2009. Mbikqyrja e kujdesshme dhe rregullimet e sistemit bankar u erdhën në ndihmë bankave, të cilat hynë në krizë në gjendje të shëndoshë dhe mund të mbështeteshin në aftësinë për të paguar para pasi kishin likuiditete. Ato u zhvilluan edhe më tej nga mbështetja e bankave të huaja mëma (FMN, 2009). Huadhënia bankare u ngadalësua apo reduktuanë të gjitha vendet e Evropës Juglindore, si

edhe në vendet e reja anëtare të Bashkimit Evropian. Shqipëria ka qënë një nga vendet ku huatë që i janë dhënë sektorit privat kanë vazhduar të rriten, ndonëse me ritme më të ngadalta (figura II.4).

Figura II.4. Huatë bankare për sektorin privat jo-financiar, ndryshimi i përqindjes gjatë vitit pararendës, Shqipëria dhe vende të tjera të Evropës Juglindore, Shtator 2008- Mars 2010



Burimi: Instituti i Vienës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (WIIW)- Baza e të dhënave për investimet e huaja direkte duke u bazuar në statistika kombëtare.


Qe nga fillimi i krizës, kushtet e kreditimit janë shtrënguar dhe sektori privat ka hasur në vështirësi për përmbushjen e detyrimeve të veta. Përqindja e kredive të këqia është rritur perseri në të gjitha vendet e rajonit për të cilat disponohen të dhëna (figura II.5). Shqipëria renditet në vendin e dytë për nga numri i këtyrë kredive, afërsisht me 12%, gjë që flet për një falimentim të mundshëm të një pjese të rëndësishme të sektorit privat. Bankat kanë akumuluar stokun dhe nuk duken të jenë në ndonjë rrezik.

Bankat italiane dhe austriake që janë aktive në Shqipëri i kanë rezistuar krizës. Megjithatë, **bankat mëma** të filialeve greke po përballen me kohë të vështira për shkak të krizës ekonomike në Greqi dhe presin mbështetje nga qeveria dhe Bashkimi Evropian. Kjo mund edhe t'i shpëtojë, por aktivitetet e tyre do të tkurren për shkak të një tregu vendas që po vjen edhe ai në tkurrje dhe ku risku po vjen duke u rritur. E ardhmja e filialeve bankare greke në Shqipëri varet në një shkallë të madhe nga aftësia e tyre për të financuar aktivitetet e veta nga depozitat e mbledhura në nivel lokal duke qënë se ato nuk mund të varen më nga mbështetja e degëve mëmë. Për bankat greke mëmë mund të jetë më fitimprurëse të kreditojnë shtetin grek dhe rrjedhimisht kjo do të thotë që degëve të tyre në Shqipëri do tu kalojë më pak kapital. Megjithatë, një kufizim/tkurrje e aktivitetit të tyre në Shqipëri nuk do të paraqiste problem për sektorin financiar në Shqipëri, duke qënë se ka një numër të madh bankash që mund ta marrin këtë biznes.

Bankat e nivelit të dytë që operojnë aktualisht në Shqipëri janë rezultat/rrjedhojë e privatizimit dhe e disa investimeve të reja. Gjatë vitit 2008, pronësia e kapitalit të sistemit bankar kaloi përmes ndryshimeve të rëndësishme strukturore, që sollën një rritje të dominimit nga bankat e huaja dhe institucionet e tjera financiare. Shitja e aksioneve të Bankës Credins, që ishte në pronësi të një aksioneri privat shqiptar tek dy investitorë të huaj ka rritur peshën e kapitalit të huaj në atë bankë nga 5% që ishte në vitin 2007 në 33.3% në vitin 2009. Dy aksionerët e bankës ProCredit, Fondacioni Fefad (kapital vendas) dhe IFC-ja (kapital nga

Grupi i Bankës Botërore) ua kanë shituar aksionet e tyre Procredit Holding (Gjermani). Gjatë vitit 2007, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) u bë aksonere në Union Bank, me një pjesëmarrje aksionesh prej 12.5%. Kjo ngjarje shënoi hyrjen e kapitalit të huaj në bankën e fundit në vend që ishte plotësisht në pronësi të investitorëve vendas.

Figura II.5. Përqindja e kredive të këqia në totalin e huave, Shqipëria dhe vende të tjera të Evropës Juglindore, shtator 2008- mars 2010.



Burimi: Instituti i Vienës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (WIIW)- Baza e të dhënave për investimet e huaja direkte duke u bazuar në statistika kombëtare.

Gjithashtu, në vitin 2007, numri i bankave në Shqipëri ra nga 17 në 16 (tabela II.3). Kjo për shkak të shkrirjes së Bankës Intesa San Paolo, që u krijua si bashkim i bankave Sanpaolo IMI dhe Intesa Bank me Bankën Amerikane të Shqipërisë (në tabelën II.4 parashtrohet një listë e plotë e bankave në vend, sipas pronësisë që nga viti 2008). Megjithatë, punësimi në banka dhe numri i degëve të bankave ka vazhduar të rritet (tabela II.3).

Gjatë vitit 2008, kapitali statutor i bankave në Shqipëri që mbahej nga investitorë të huaj u rrit me 12.5 miliardë Lekë (33%), ndërsa kapitali vendas ra me 266 milionë Lekë (5.6%). Deri në fund të muajit dhjetor të vitit 2008, kapitali i huaj në sistemin bankar shqiptar vlerësohet të jetë rritur në 50.3 miliardë lekë ose 91.8% e totalit (nga 88.8% në fund të vitit 2007), ndërsa kapitali vendas vlerësohet të jetë tkurrur në 4.5 miliardë lekë ose 8.2% të totalit (Banka e Shqipërisë, 2009).

Tabela II.2. Treguesit kryesorë të madhësisë së sistemit bankar në Shqipëri, 2003-2008

Treguesit	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Nr i bankave	15	16	17	17	16	16
Nr. punonjeshve	2.236	2.816	3.479	4.189	5.155	6493
Nr i degeve/agjensive	161	188	250	294	399	511

Burimi: Të dhënat sipas Bankës së Shqipërisë

Treguesit e stabilitetit të sektorit bankar janë përmirësuar. Tashmë janë futur shërbime të reja dhe më bashkëkohore. Megjithatë, karakteristikat e përgjithshme pozitive sipas standardeve ndërkombëtare bankare nuk i plotësojnë të gjitha nevojat e ekonomisë së vendit. NMV-të ende kanë akses të kufizuar përkundrejt financimit të bankave si dheekziston nevoja për një përmirësim të skemave të garancive të kredive.

Formatted: Swedish (Sweden)

Bankat me pronësi të huaj kanë kanalizuar, në një farë mase, impaktin negativ të krizës financiare ndërkombëtare në Shqipëri. Ndonëse kreditimi i sektorit privat vazhdoi të rritej edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2010, përqindja e zgjerimit erdhi në rënie, ndërsa ajo e huave të këqia në totalin e huave nisi të rritej. Megjithatë, këto karakteristika nuk janë për shkak të pronësisë së huaj *në vetvete*, por zbatohen në përgjithësi për bankat në shumicën e vendeve evropiane.

Table II.4. Bankat ne Shqiperi sipas Pronesise, 2008


Banka	Emri i Aksionereve	% e Aksioneve	Pronesia	Vendi i Origjines se Aksionereve
Raiffeisen Bank	Raiffeisen International Bank – Holding AG	100	Private e Huaj	Austria
	Calik Sekei Konsorsiyum Yatirin A. S	60	Private e Huaj	Turqia
Banka Kombetare Tregtare (BKT)	EBRD	20		Institucion Nderkombetar
	IFC	20		Institucion Nderkombetar
United Bank of Albania	Ministria e Finances, Shqiperi	40	Qeveria	Shqiperia
	Shamil Bank of Bahrein	20		Arabia Saudite
	IDB Jeddah Malaysian Co Business Fokus	6.3	Private e Huaj	Majlazia
	Dallah Albaraka Holding	10	Private e Huaj	
	7 Individe	8.7	Private e Huaj	Arabia Saudite
	Pireus Bank	90.7	Private e Huaj	
	Dafnila S.A.	1.3	Private e Huaj	
Banka Tirana	5 Individe	8	Private e Huaj	Greqia
Dege e Bankes Kombetare Greke	National bank of Greece	100	Private e Huaj	Greqia
Alpha Bank	Alpha Bank of Greece	100	Private e Huaj	Greqia
Banka Italiane e Zhvillimit	Veneto Banca Holding S.c.p.A.	100	Private e Huaj	Italia
ProCredit Banka Nderkombetare Tregtare	Pro Credit Holding	80	Private e Huaj	
	Commerzbank AG	20	Private e Huaj	Gjermania
Emporiki Bank	ICB Holding AG	100	Private e Huaj	Svicra (Majlazia)
Banka e Kreditit Shqiptar	Emporiki Bank of Greece	100	Private e Huaj	Greqia
	3 individe	100	Private e Huaj	Kuvait
Credins	10 Individe	68.5	Private Vendase	
	Bushati Sh.p.k.	4.7	Private Vendase	
	EMIGRES	4.2	Private e Huaj	Shqiperia-Spanja
	BFSE Holding BV	22.2	Private e Huaj	Hollanda
	SECO (SIFEM)	3.2	Private – Publike	Svicra
Banka Popullore	Societe Generale	75	Private e Huaj	Francea
	9 Individe	25	Private e Huaj	Shqiperia
Union Bank	Financial Union of Tirana	83.13	Private e Huaj	Shqiperia
	EBRD	12.5		Institucion Nderkombetar
	2 Individuals	4.37	Private Vendase	Shqiperia
First Investment Bank	First Investment Bank, Bulgaria	99.998	Private e Huaj	Bullgaria
	Vitosh Ventures AD	0.0001	Private e Huaj	Bullgaria
	First Finance Brokerage House LTD	0.0001	Private e Huaj	Bullgaria
Intesa San Paolo	Intesa San Paolo S.p.a	78.5	Private e Huaj	Italia
	Albanian-American Fund of Enterprises	12.2	Private e Huaj	SHBA
	EBRD	7.8	Private e Huaj	Institucion Nderkombetar
Intesa San Paolo	Italian Society for Foreign Enterprises	1.5	Private e Huaj	Italia

Burimi: Sipas Bankes se Shqiperise

C. Investimet e huaja direkte në shërbimet e sigurimeve

Gjatë vitit 2008, në Shqipëri operonin dhjetë shoqëri sigurimesh, qofshin të huaja apo vendase. Shtatë prej tyre ishin kompani sigurimi jo jete, dy ishim kompani sigurimi jete dhe njëra i ofronte të dyja shërbimet. Kompanitë që bënin sigurim jo jete, sipas përqindjeve në treg ishin: Sigal, Sigma, Instituti i Sigurimeve INSIG, Atlantik, InterAlbanian, Albsig, Intersig dhe Eurosig (figura II.6). Sigal-i udhëhiqte tregun me afërsisht 27.2% të primeve të sigurimit jo-jetë.

Figura II.6. Shqipëria: Ndarja e tregut të sigurimeve jo-jetë sipas ofruesëve, 2008




Burimi: Të dhënat sipas Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.

*Kompanitë të theksuara me të zeze, janë të zotëruar filialet e huaja me mbi 10%.

Shërbimet e sigurimit të jetës ofroreshin nga kompanitë: Sigal Life, Insig dhe Sicred (figura II.7). Sigal – Life kryesonte tregun me 40% të primeve.

Figura II.7. Shqipëria: Ndarja e sigurimit të tregut të sigurimit të jetës sipas ofruesve, 2008



Burimi: Të dhënat sipas Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.

*Kompanitë të theksuara me të zeze, janë të zotuar filialet e huaja me mbi 10%.

Kompanitë e huaja të sigurimeve operojnë në tregun shqiptar qysh nga viti 2007. Gjatë vitit 2008, shoqëritë e huaja e rritën edhe më tej pjesëmarrjen e tyre. Në janar të vitit 2008, u miratua pjesëmarrja e UNIQA International Beteiligungs-Verwaltungs GmbH (Austri) në Sigal Holding (pronar i shoqërive Sigal dhe Sigal-Life) me 45.6% të pronësisë. Në tetor të vitit 2008, pjesëmarrja e shoqërisë TBIH Financial Services Group N.V Amsterdam (me 60% të pronësisë nga Vienna Insurance Group) në shoqërinë e sigurimeve Sigma u rrit nga 75% në 87%.

Nga ana tjetër, shoqëritë e sigurimeve që operojnë në tregun shqiptar kanë rritur gjithashtu praninë e tyre jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Insig-u, Sigal, UNIQA GROUP Austria dhe Sigma janë të pranishme edhe në Kosovë dhe në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ndërsa shoqëria Albsig ka krijuar një degë të saj në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Sigma i ka rritur investimet e saj në degën e Kosovës përmes futjes së aksioneve të tjera në vitin 2008.

D. Konkluzione

Përfshirja e investitorëve të huaj në shërbimet financiare dhe ato të telekomunikacionit, dy prej industrive më të mëdha përfituese, erdhi kryesisht si pasojë e privatizimit. Pas privatizimit në kompanitë në fjalë u investuan shuma të rëndësishme kapitali. Ndonëse ekonomia shqiptare ka përfituar nga investimet e huaja direkte në këto shërbime ende ka shumë vend për përmirësime të mëtejshme në rolin e tyre në zhvillimin e vendit (si p.sh. në lidhje me aksesin e NMV-ve ndaj fondeve) dhe për zbutjen e risqeve potenciale që lidhen me investimet e huaja direkte (si p.sh. risqet e kontigjencës në tregjet financiare). Për të thithur më shumë investime të huaja direkte në këto shërbime dhe të tjera, por edhe në sektorë të tjerë, si edhe për përfituar më shumë prej tyre, duke minimizuar në të njëjtën kohë kostot dhe risqet, qeveria duhet të hartojë një politikë më gjithëpërfshirëse dhe më efektive në lidhje me investimet e huaja direkte.

KAPITULLI III. POLITIKAT DHE MASAT PËR THITHJEN DHE PËRFITIMIN NGA INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI

A. Kuadri ligjor dhe rregullimit të marrëdhënieve institucionale për investimet e huaja direkte në Shqipëri

1. Mjedisi në ndryshim për biznesin

Me zanafillën e proceseve të reformës ekonomike drejt një ekonomie tregu në vitet 90-të, Shqipëria hyri në udhën e transformimeve politike, ekonomike, ligjore dhe institucionale të ekonomisë së saj. Qysh nga fundi i viteve 90-të, qeveria ka ndërmarrë një sërë reformash strukturore, duke përfshirë reformën për tokën, reformën e tregut financiar, liberalizimin e cmimeve dhe privatizimin. Gjatë kësaj periudhe janë privatizuar pothuajse të gjitha SME-të dhe ka patur progres të rëndësishëm në privatizimin e industrive strategjike, si: telekomunikacioni dhe sektori bankar. Ky i fundit ka rritur gradualisht numrin e shërbimeve financiare që ofron dhe kreditimin e biznesit. Vendi tashmë karakterizohet nga një ekonomi e hapur, me një treg dhe regjim investimesh liberale.

Pavarësisht një rritjeje të shënuar vitet e fundit, flukset e investimeve të huaja direkte në Shqipëri janë ende relativisht të ulëta në krahasim me ato të vendeve fqijne. Terheqja e niveleve më të larta të investimeve të huaja direkte ende mbetet një sfidë për vendin. Procesi i reformës vazhdon dhe ka për qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mjedisit të biznesit dhe të investimeve përmes uljes së barrierave të ndryshme ligjore dhe administrative për bërjen e biznesit në Shqipëri.


a. Vlerësimet krahasuese ndërkombëtare

Në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2010, ndër të tjera theksohet se përsa u takon kriterëve ekonomike Shqipëria ka arritur një shkallë të caktuar të stabilitetit makro-ekonomik, si edhe janë bërë përpjekje të rëndësishme në lidhje me përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të *acquis*-ve të Bashkimit Evropian, në vecanti në disa fusha të tregut vendas, marrëdhëniet tregtare, dogana dhe tatime. Megjithatë, Shqipëria ende përballet me sfida të mëdha përsa i takon zbatimit dhe ekzekutimit të legjislacionit, ndaj edhe për tu bërë një ekonomi funksionale tregu, Shqipëria duhet të forcojë më tej qeverisjen, të përmirësojë performancën e tregut të punës, të garantojë njohjen e të drejtave të pronësisë dhe të forcojë sundimin e rendit. Me qëllim përballimin e trysnive konkurrese afat-mesme, si edhe forcave të tregut brenda Bashkimit Evropian, Shqipëria duhet të forcojë infrastrukturën fizike dhe kapitalin njerëzor, si edhe të vijojë me reforma të mëtejshme strukturore.

- Sic përmendet në kapitullin I, Shqipëria renditet në pozicion relativisht të lartë në renditjen globale sipas Indeksit të Performancës të Investimeve të Huaja Direkte të UNCTAD-it. Rënditja më e fundit sipas këtij treguesi (ajo për vitin 2009) e vendos Shqipërinë në vendin e 25-të midis 141 vendeve, cka flet për një përmirësim të shpejtë të pozicionit që Shqipëria mbante në vitin 2006, kur ishte në vendin e 80-të. Nga ana tjetër, Shqipëria ka renditje të ulët në lidhje me potencialin e investimeve, gjë që tregon se një infrastrukturë e dobët, ndërprerjet dhe mungesat e energjisë, si edhe një aktivitet modest në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit mund të përbëjnë pengesë për investimet e huaja direkte në të ardhmen.

- Në raportin e Bankës Botërore “Të bësh biznes”, për vitin 2011, Shqipëria renditet në vendin e 82-të nga 181 ekonomi, përsa i takon lehtësisë së bërjes së biznesit (Banka Botërore, 2011). Pra, Shqipëria renditet në mes të grupit, po të krahasohej me vende të tjera të Ballkanit Perëndimor (figura III.1).

Figura III.1. Lehtësia e bërjes së biznesit: renditja globale e Shqipërisë dhe vendeve të tjera sipas Bankës Botërore



Burimi: Banka Botërore, IFC, *Të bësh biznes, 2011: Të sjellësh ndryshimin për sipërmarrjet*, botim i përbashkët i Palgrave MacMillan, IFC dhe Bankës Botërore (Uashington D.C.: Banka Botërore) disponohet në këtë adresë: <http://www.doingbusiness.org/documents>.

Përsa i përket dhjetë fushave kryesore të treguesëve të bërjes të biznesit ekziston një hendek i madh midis performancës të vendit sipas treguesëve të ndryshëm. Sipas raportit “Fillimit i një biznesi”, Shqipëria renditet në vendin e 68-të për vitin 2009, në vendin e 46-të në vitin 2010, ndërsa në vitin 2011 kaloi në vendin e 45-të të renditjes globale. Koha mesatare me ditë për fillimin e një biznesi është pesë ditë, në krahasim me mesataren e OECD-së që është 13 ditë. Përsa i takon “marrjes së kredive” dhe “mbrojtjes së investitorëve”, në vitin 2010 Shqipëria renditet në vendin e 15-të nga 183 vende pjesëmarrëse për të dy treguesit, cka e vendos atë midis vendeve me performancë të lartë përsa i përket reformave. Treguesi i “marrjes së kredive” reflekton përmirësimin e efikasitetit të sistemit bankar shqiptar, pas privatizimit dhe investimet e huaja. Fushat e përfshira në treguesit e bërjes së biznesit, ku vendi është midis vendeve me performancën më të dobët në botë janë: “lejet e ndërtimit”, “pagesa e taksave” dhe “mbyllja e një biznesi”. Duhet të përmirësohet certifikimi i pronësisë, si edhe të thjeshtohet lëshimi i të gjitha lejeve. Në 2010-n, në Shqipëri, për kompanitë u bë me e lehtë dhe me pak të kushtueshme pagesa e taksave si pasojë e amendimit të disa ligjeve, reduktimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe integritetit të plotësimin e dokumenteve dhe kryerjen e pagesave elektronike.

- Në Raportin e Konkurrueshmërisë Globale për periudhën 2010-2011 të Forumit Ekonomik Botëror (WEF), Shqipëria renditet në vendin e 88-të nga 133 vende pjesëmarrëse me një rezultat 3.94, duke përmirësuar renditjen e saj në vitet pararendëse (WEF, 2010). Komponentët më të përparuar të indeksit të konkurrueshmërisë përfshijnë:
 - Institucionet;
 - Eficiencë të mirë tregu, për shkak të lehtësisë të fillimit të një biznesi; dhe
 - Eficenca e tregut të punës- Fleksibilitetin e percaktimit të pagave, praktikave të punësimit dhe largimit nga puna, lidhja midis pagave dhe produktivitetit (WB 2011).

Faktorët më problematikë që pengojnë konkurueshmërinë në Shqipëri, sipas këtij raporti janë aksesimi në financa, korrupsioni dhe regulloret e taksave. Fushat problematike këtu janë pothuajse të njejtat me ato të diskutuara më sipër në lidhje me treguesit e bërjes së biznesit.

- Indeksi i OECD-së në lidhje me Reformën e Investimeve për vitin 2010 tregon se progress ka patur në reformimin e politikave dhe institucioneve që influencojnë mjedisin e investimeve në Shqipëri (OECD, 2010). Sipas treguesëve për këtë indeks, dimensionet ku reforma e politikave është e avancuar janë:

- Politikat e investimeve;
- Politikat tregtare

Dimensionet ku reformat kanë qënë të ngadalta janë:

- Aksesimi në financa (regjistër i paplotë i kredive, kadastra, një treg aksionesh i pazhvilluar)
- Politikat tatimore (efikasiteti i mbledhjes së taksave)
- Kapitali njerëzor (arsimi profesional dhe arsimi i lartë)

Sipas analizës së renditjes së tyre, Shqipëria ashtu si edhe vende të tjera të Evropës Juglindore kanë bërë progres të rëndësishëm në integrimin e mëtijshëm në sistemin shumëpalësh të tregtisë dhe në përmirësimin e kuadreve ligjore që ndikojnë aksesin në financa dhe mbrojtjen e pronës fizike. Por reformat duhet të vazhdojnë

- Për trajtimin e mangësive të aftësive profesionale përmes përmirësimit të sistemeve të arsimit dhe trainimit;
- Për përshpejtimin e miratimit të regulloreve teknike dhe standardeve të BE-së, si edhe të masave sanitare dhe fitosanitare;
- Për të ndihmuar kompanitë për të siguruar akses financiar përmes përmirësimit të funksionimit të masave të garancisë së kredive dhe regullimit të mikrofinancave. Qeveritë gjithashtu mund të hulumtojnë masa për zhvillimin e një tregu për ekuitetin informal.

- Ndërsa raporti i Bankës Botërore me titull “Investimi përtej Kufijve” e përmend Shqipërinë ndër dhjetë vendet me të shpejta të rajonit përse i takon procesit të fillimit të shoqërive të huaja (Banka Botërore, 2010) në Indeksin e Lirisë Ekonomike për vitin 2010 të Fondacionit Heritage Foundation, Shqipëria renditet në vendin e 53^{te} nga 179 vende (Heritage Foundation, 2010).

b. Politikat e investimeve të huaja direkte – regjimi i investimeve

Në vitin 1993, Shqipëria miratoi një kuadër ligjor në favor të investimeve të huaja direkte, të cilat rrjedhimisht u përmirësuan. Karakteristikat kryesore të regjimit aktual të investimeve janë:

- Ekonomia shqiptare është e hapur për të gjithë investitorët. Nuk kërkohet autorizim paraprak për investimet. Si regull, të gjithë sektorët janë të hapur për investime të huaja. Ligji garanton trajtim të barabartë dhe të paanshëm. Investimet nga investitorët e huaj dhe ata vendas lejohen sipas të njejtave kushte.
- Nuk kërkohet autorizim paraprak për investitorët e huaj që duan të krijojnë një kompani.

- Kuadri ligjor për investimet e huaja direkte në përgjithësi respekton parimin e trajtimit kombëtar. Kufizimet për trajtimin kombëtar lindin për sektorë që mbulohen nga kuadro të vecanta legjislative si p.sh. : prodhimi i armëve, transport i brendshëm detar, peshkimi dhe shërbimet e noterisë dhe përmbarimit.
- Në Ligjin për Investimet e Huaja theksohet se investimet e huaja nuk mund të nacionalizohen apo shpronësohen, me përjashtim të rasteve të përcaktuara nga ligji, si edhe në raste të interesit publik. Në këto raste, procedurat mund të zhvillohen pa diskriminim dhe me një kompensim të barabartë me vlerën reale të tregut.
- Investitorët në Shqipëri gëzojnë të drejtën e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave që lidhen me investimet e tyre. Palët në një mosmarrëveshje mund të bien dakord ta paraqesin mosmarrëveshjen për tu marrë në konsideratë nga një institucion arbitrazhi. Në rast dështimi, investitorët e huaj gëzojnë të drejtën ta paraqesin çështjen në një gjykatë shqiptare apo në Gjykatën e Arbitrazhit në Tiranë. Në rastin e një mosmarrëveshjeje për shkak diskriminimi, transferimi të aseteve apo shpronësimi indirekt të një investimi të huaj nga qeveria, investitori mund ta dërgojë çështjen në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID). Marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare kanë eprësi juridike mbi legjislacionin vendas.
- Sipërmarrjeve me shumicë aksionerësh të huaj, që janë të regjistruara në Shqipëri si persona juridikë u lejohej të kenë në pronësi cdo lloj toke/trualli, kështu që shtetasit e huaj mund të blejnë tokë pa asnjë kufizim përmes kompanive që ata krijojnë juridikisht në Shqipëri. Problemet mbeten më sistemin e kadastrës dhe atë të pronësisë së titujve.
- Kompanitë që investojnë në Shqipëri gëzojnë të drejtën të punësojnë shtetas të huaj. Fondet që lidhen me investimet mund të transferohen jashtë shtetit në një monedhë të konvertueshme, të llogaritur sipas kursit të këmbimit në datën e transfertës. Mund të ketë kufizim transfertash për mospagesë taksash apo për mospërbushje të detyrimeve dhe për vendime gjyqësore.
- Ndër vite në Shqipëri ka patur problem pronësie për shkak të disa palëve që pretendonin pronësi për të njëjtin truall. Qeveria e ka pranuar këtë si një pengesë për investimet e huaja direkte dhe rrjedhimisht ka qene proaktive duke ofruar nje zgjidhje. Ndaj edhe kohët e fundit ka hartuar një projekt-ligj të ri që mbron dhe garanton investimet e investitorëve të huaj,
- Shqipëria ka në fuqi 37 marrëveshje dypalësh për mbrojtjen dhe nxitjen reciproke të investimeve. Marrëveshjet janë nënshkruar me këto shtete: Austri, Belgjikë dhe Luksemburg, Bosnje-Hercegovinë, Bullgari, Kinë, Kroaci, Republika Ceke, Danimarkë, Egjipt, Finlandë, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Izrael, Itali, Kosovë-UNMIK, Kuvait, Republikën e Koresë, Lituani, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Malaizi, Moldavi, Hollandë, Poloni, Rumani, Federata Ruse, Serbi, Slloveni, Spanjë, Suedi, Zvicër, Tunizi, Turqi, Ukrainë, Britani e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara⁷.

⁷ Në gjuhën angleze renditja është dhënë sipas alfabetit. Sigurisht kjo renditje e shteteve ndryshon nga përkthimin në gjuhën shqipe- shën i përkth.

Për të garantuar konkurrueshmërinë maksimale të vendit dhe për ta bërë atë vendin më tërheqës për investitorët e huaj, deri në 2013 janë parashikuar reforma të mëtejshme administrative, fiskale dhe gjyqësore. Ndërsa mjedisi në përgjithësi dhe politikat gjithëpërfshirëse tashmë i mbështesin këto objektiva, qeveria do të hartojë dhe zbatojë një program me instrumente specifike për të mbështetur një zhvillim të bashkënduar sic duhet të industrisë dhe eksporteve. Instrumentet që do të përdoren janë:

- krijimi i lehtësive specifike të infrastrukturës si p.sh.: ngritja e pesë parqeve industriale apo inkubatorëve të biznesit;
- kombinimi i parqeve industriale me lehtësi fiskale të ngjashme me ato të zonave të lira;
- përdorimi i subvencioneve nga fondet publike për investime në teknologji novatore, fonde mbështetëse për SME-të etj.; dhe
- krijimin dhe/ose fuqizimin e rrjeteve konsultative/këshillimore apo informacionit promociional bazuar mbi modele që janë provuar se janë të suksesshme për rritjen e konkurrueshmërisë dhe nxitjen e investimeve të huaja.

c. Reformat e kohëve të fundit

Si themel të politikave të saj ekonomike, qeveria shqiptare ka prezantuar politika në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat, me qëllim që të garantojë:

- përmirësimin e klimës dhe infrastrukturës së biznesit,
- reduktimin e ekonomisë informale,
- përshtetimin e procesit të privatizimit në sektorët strategjikë si: telekomunikacione dhe sigurime,
- zgjerimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit bankar,
- zhvillimin e tregut të sigurimeve,
- rritjen e investimeve në naftë dhe gaz; dhe
- zhvillimin e shërbimeve portuale dhe aeroportuale.

Gjithashtu, përparësi për qeverinë mbeten investimet në energjetikë dhe infrastrukturë. Në bashkëpunim me donatorë të tjerë, qeveria shqiptare do të synojë mbledhjen e fondeve shtesë, në partneritet me sektorin privat. Partneriteti publik-privat konsiderohet si një potencial real për gjenerimin e kursimeve në ekonomi dhe clirimin e fondeve buxhetore për t'i përdorur ato në sektorë prioritarë.

Qeveria shqiptare ka ndërmarrë një reformë gjithëpërfshirëse regullatore. Thelbi i këtyre masave konsiston në uljen e barrës administrative dhe kostos të bërjes së biznesit. Më poshtë parashtrihen hapat që janë ndërmarrë gjatë periudhës 2006–2010.

Reforma e procesit të regjistrimit të biznesit

Qysh nga viti 2007, regjistrimi i një biznesi bëhet brenda një ditë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) për më pak se 1 euro. Gjithashtu, numri i hapave për fillimin e një biznesi të ri është ulur nga 10 në 5. Brenda një ditë, me anë të një aplikimi të vetëm, bizneset e reja mund të regjistrohen *online* për të plotësuar kërkesat në lidhje me taksat, sigurimin shëndetësor dhe krahun e punës.

Lëshimi i licencave

Janë thjeshtuar procedurat e licencimit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Gjatë periudhës 2007-2008, reformat çuan në eliminimin e një numri tejet të madh licencash dhe lelesh dhe rrjedhimisht nga 170 kërkesa për licenca që kërkoreshin më parë, tani 104 janë hequr. Bazuar në ligjin Nr.10081 të datës 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", në qershor të vitit 2009 nisi nga puna Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL), me qendër në Tiranë dhe degë në qytetet e Korçës, Shkodrës dhe Vlorës.

Licencat nevojiten në fushat e mëposhtme: siguri kombëtare, rend publik dhe mbrojtje civile, ushqim dhe shëndetësi, mjedis dhe burimet bazë të mjedisit, burime minerare, hidrokarbure, energjetikë, territor dhe ndërtim, trashëgimi kulturore, transport, prodhim, depozitim, përdorim dhe/ose tregëtim i produkteve dhe/ose substancave apo pajisjeve të tjera që përbëjnë rrezik, arsim dhe shkencë, shërbime noterie, shërbimet e përmbarimit, financa publike. Aktivitetet që kërkojnë licencë janë të ndara në tri grupe: (për grupet I dhe II ato lëshohen nga QKL-ja brenda dy apo katër ditëve, ndërsa për grupin III, licencat referohen tek ministrinë e linjës dhe koha për lëshimin e një licence është 10-30 ditë).

Kodi tregëtar

Ligji nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare", që zëvendësoi ligjin e vitit 1992 përcakton llojin e statusit juridik të shoqërive. Ligji i ri e sjell legjislacionin shqiptar në të njëjtat linja me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian dhe reflekton amendamentet e tjera të legjislacionit shqiptar si: Kodin Civil, Ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit, Kodin e Punës dhe Ligjin për Titujt, si edhe ligje të tjera të rëndësishme. Ligji parashikon dispozita për sipërmarrësit në lidhje me krjimin e shoqërive tregtare, përfaqësive të tyre, detyrime besimi, aksione të punonjësve, shkrirjen dhe likuidimin e partneriteteve të përgjithshme dhe të kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, shoqëritë aksionere dhe ristrukturimin e shoqërive.

Reforma fiskale

Hapat e reformës fiskale të ndërmarra gjatë viteve 2007–2008 dhe politika ekspansioniste fiskale e ndjekur gjatë gjysmës së parë të vitit 2009 e bënë sistemin tatimor shqiptar më të lehtë dhe më inkurajues për zhvillimin e biznesit. Paralelisht, shpërndarja e barrës tatimore është bërë më e barabartë dhe më pak corientuese. Objektivi kryesor i politikës tatimore është balancimi i buxhetit publik me përdorimin e taksave, si një instrument i politikave ekonomike për nxitjen e punësimit dhe investimeve në ekonomi. Reforma e politikës tatimore është bazuar mbi idenë e uljes së përqindjes tatimore dhe në të njëjtën kohë zgjerimin e gamës të tatimpaguesëve. Hapat kryesorë të reformës tatimore janë: |

- reduktimi gradual i përqindjes së tatim-fitimit nga 25% në vitin 2000 në 10% në vitin 2010;
- ndryshimi në sistemin e tatimit mbi të ardhurat personale nga progresiv në proporcional, me të njëjtën përqindje tatimi si për të ardhurat e kompanive (10%);
- ulje e ndjeshme e barrës tatimore mbi të ardhurat nga puna: aktualisht totali i kontributit si taksë nga paga bruto për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore është 27.9% e pagës mujore bruto, duke shënuar një ulje nga 41.9% që ishte në vitin 2000. Megjithatë, kjo masë la një hendek të konsiderueshëm në fondin e pensioneve.

Politika tregtare

Integrimi i ekonomisë shqiptare në tregjet rajonale të Evropës Juglindore mund të kompensojë dobësitë e kësaj ekonomie në lidhje me madhësinë e tregut vendas, duke i hapur perspektivën për t'i shërbyer të një tregu me rreth 50 milionë banorë. Integrimi nxitet më tej përmes liberalizimit të tregtisë, eksporteve dhe inkurajimit të investimeve të huaja direkte. Qeveria ka ndërmarra hapa për harmonizimin e legjislacionit shqiptar me rregullat e tregtisë ndërkombëtare dhe me Politikën e Përbashkët Tregtare Evropiane (European Common Commercial Policy). Qysh me anëtarësimin e saj në Organizatën Botërore të Tregtisë në shtator të vitit 2000, Shqipëria ka liberalizuar plotësisht regjimin e import-eksportit të mallrave. Hapa të mëtejshëm të politikës tregtare do të arihen përmes eliminimit të të gjitha barrierave jo-tarifore për tregtinë.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian e nënshkruar me datë 1 dhjetor 2006 përmban një marrëveshje të ndërmjetme të tregtisë së lirë me BE-në, që hyri në fuqi me datë 1 prill 2009. Kjo marrëveshje, që është një hap i rëndësishëm në rrugën drejt anëtarësimin në Bashkimin Evropian, parashikohet të hapë mundësi të reja për zhvillimin e vendit.

Qysh nga janari i vitit 2004 ka përfunduar dhe ka nisur nga zbatimi një rrjet i plotë i marrëveshjeve të tregtisë së lirë në rajonin e Evropës Juglindore, me Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kosovën, Serbinë, Malin e Zi, Bullgarinë, Rumaninë, Bosnje-Herzegovinën, Kroacinë dhe Moldavinë. Kjo u pasua nga procesi i liberalizimit dhe adoptimit të marrëveshjes së unifikuar të tregtisë së lirë, të njohur ndryshe si Marrëveshja e Tregtisë së Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA) në vitin 2006, e nënshkruar nga të gjitha palët dhe plotësisht në fuqi qysh nga nëntori i vitit 2007. Kjo marrëveshje nuk është një transformim formal i rrjetit të shumë marrëveshjeve të tregtisë së lirë në një marrëveshje, por ajo pasqyron një nivel më të lartë të hapjes së tregut dhe të bashkëpunimit rajonal midis vendeve të rajonit. Politika e liberalizimit ka vijuar me marrëveshjen e tregtisë së lirë midis Shqipërisë dhe Turqisë, si edhe me marrëveshjen e tregtisë së lirë të Shqipërisë me vendet e Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë (EFTA).

Tarifat e aplikuara nga Shqipëria për importet jashtë Bashkimit Evropian janë shumë të ulëta. Në vitin 2008, tarifa mesatare e aplikuar ishte 2.3%. Gjatë vitit 2008, u ndërmorr një reformë e rëndësishme në lidhje me procedurat doganore përmes informatizimit të të gjitha pikave doganore, gjë që përmirësoi ndjeshëm shërbimet për bizneset, uli kohën për plotësimin e dokumentacionit dhe kontrollit të mallrave të tregtuara.

Zonat e lira & Parqet industriale

Qeveria shqiptare ka miratuar akte ligjore dhe nën-ligjore, d.m.th ligjin nr. 9789, të datës 19 korrik 2007 "Mbi krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike" dhe VKM nr. 860, të datës 10 tetor 2007 "Mbi miratimin e rregulloreve në lidhje me krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike", me qëllim sigurimin e bazës ligjore dhe institucionale për krijimin e zonave të lira ekonomike dhe parqeve industriale për krijimin e aktiviteteve nga sipërmarrjet. Qysh nga viti 2010, qeveria ka miratur nëntë zona ekonomike. Tetë prej tyre kanë statusin e parqeve industriale, ndërsa njëra statusin e zonës së lirë. Këto janë parqet industriale të Spitalës (duke u ndërtuar, në bashkëpunim me partneritet publik dhe privat); Vlora (në zhvillim); Koplik (manufakturë, agro-përpunim, tregti, eksport-import); Shengjin (manufakturë, agropërpunim, tregti, eksport-import); Parku Industrial i Elbasanit (në zhvillim: industria, aktivitetet tregtare, shërbime); Parku Industrial i Shkodrës (në zhvillim, manufakturë, ushqime, shërbime, tregti, import-eksport); Parku Industrial i Lezhës (manufakturë, agropërpunim, tregti, eksport-import dhe shërbime), parku industrial i Laknasit

(Tiranë) dhe zona e lirë ekonomike e Vlorës. Parashikohen afërsisht 60 milionë euro investime që do të akordohen për aktivitet në parqet industrial dhe krijimi i 30,000 vendeve të reja të punës.

Privatizimi

Privatizimi ka qënë pjesë e rëndësishme e procesit të reformave të vendit, si edhe një instrument po kaq i rëndësishëm për thithjen e investimeve të huaja (kapitulli I). Strategjia e privatizimit e miratuar me Ligjin Nr. 8306 të datës 14 mars 1998 ndër të tjera synoi tërheqjen e investitorëve potencialë strategjikë, nxitjen e ekonomisë përmes përdorimit efikas të burimeve natyrore dhe njerëzore dhe garantimit të stabilitetit të pronësisë. Gjatë procesit të privatizimit nuk pati asnjë kufizim në lidhje me pjesëmarrjen e investitorëve të huaj në këtë proces. Investitorëve të huaj u lejohet 100% pronësi e ndërmarrjeve të privatizuara. Ndonëse është e mundur në bazë të ligjit, shteti nuk ka ruajtur kontrollin mbi kompanitë përmes të ashtu-quajturit “aksioni i artë”.

Partneriteti Publik- Privat (PPP)

Qeveria shqiptare ka përgatitur zbatimin e plotë të paketës legjislative përmes ligjit nr. 9663, të datës 18 dhjetor 2006 "Për koncensionet". Amendamentet duhet të mundësojnë rritjen e transparencës, efikasitetit dhe paanshmërisë gjatë nënshkrimit të marrëveshjeve koncensionare për projekte ku përfshihet partneriteti publik-privat (PPP). Qeveria shqiptare ka dhënë koncensione në sektorë të ndryshëm si: energjetikë, miniera, infrastruktura aeroportuale dhe manaxhimi i sistemit të ujësjellës-kanalizimeve në disa qytete të Shqipërisë.

Një nga sfidat kryesore infrastrukturore të Shqipërisë ka qënë zhvillimi i një sistemi më efikas dhe më të sigurtë të energjisë elektrike. Nga pikëpamja e furnizimit, deri në vitin 2005 pati vetëm pak investime për të zhvilluar dhe diversifikuar infrastrukturën shqiptare të prodhimit të energjisë elektrike. Këto ishin kryesisht të bazuar tek burimet hidrike, i cili nga ana e tij varej nga rreshjet. Gjithashtu, kapacitetet e importit të Shqipërisë ishin penguar nga kufizimet fizike të sistemit të transmetimit. Rezultati ishin ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike.

Projekte koncensionare në sektorin e energjetikës synojnë një prodhim sa dyfishi i prodhimit aktual të energjisë elektrike, si edhe diversifikimin e burimeve energjetike me përdorimin e energjisë si rinovueshme. Kontratat koncensionare për ndërtimin e hidrocentraleve të nënshkruara nga qeveria gjatë viteve 2007-2009 me kompani të huaja për afërsisht 1.3 miliardë euro të investimeve shtrihen përgjatë pesë viteve në vijim.

Në vitet e fundit është zbatuar një proces i ristrukturimit përmes privatizimit të kompanisë së shpërndarjes dhe zbatimit të projekteve PPP për të rritur prodhimin e energjisë dhe për të lehtësuar investimet në sistemin e transmetimit. Kontratat e nënshkruara të koncensionave përcaktojnë ndërtimin e 264 centraleve me kapacitet total të instaluar prej afërsisht 1055 MW dhe prodhim mesatar vjetor të energjisë elektrike prej 4.5 miliardë kwh. Gjithashtu janë edhe dy projekte të zbatuara për ndërtimin e linjave të interkonjeksionit dhe një për një linjë të re transmetimi me kapacitet të lartë. Realizimi i kontratave koncensionare dhe projekteve të tjera që janë duke u zbatuar do të bëjnë të mundur që Shqipëria jo vetëm të plotësojë kërkesën vendase për energji elektrike në mënyrë të pandërprerë, por edhe për tu shndërruar në një eksportues të energjisë elektrike. Një projekt tjetër i suksesshëm koncensionit është terminali i naftës, një investim shqiptaro-Italian Petrolifera me vlerë prej 57 milionë eurosh, që u inagurua në qershor të vitit 2009 në Vlorë.

Një nga konkencionet më të suksesshme është ai i aeroportit ndërkombëtar të Tiranës, që operohet nga një konsorcium i Hochtief Airport, Deutsche Investitions- und Entwicklungsgesellschaft mbH dhe Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve me anë të një kontrate Ndërto-Merr në Pronësi-Vër në Funksionim- Transfero (BOOT) për një periudhë prej 20 vjetësh. Në vitin 2009, aeroporti u shërbeu 1.4 milionë udhëtarëve, 180% më shumë se në vitin 2005.

Në industrinë e naftës, qeveria ka marrëveshje në fushën e hidrokarbureve për pushtet ekzistues dhe blloqet eksploruese me kompanitë Medoil (Britani e Madhe), Island Rockall, DWM Petroleum (Zvicër), Bankers Petroleum (Kanada), Shqipëria Stream Petroleum shpk (Kanada) dhe kompaninë Sherwood. Kohët e fundit, qeveria ka nisur përgatitjet për dy marrëveshje të tilla të reja me kompaninë Iec Visoka, për platformën e Visokës dhe me kompaninë DWM Petroleum AG për blloqet 2 dhe 3 për eksplorim nëntokësor.

Stimuj për investitorët

Legjislacioni shqiptar nuk përcakton stimuj specifike për investitorët e huaj. Kompanitë e huaja si edhe ato vendase përfitojnë njësoj nga stimujt e ofruar në ligje të ndryshme. Stimujt rregullohen përmes ligjit nr. 9374 i datës 21 prill 2005, “Për asistencën shtetërore”, të ndryshuar me anë të ligjit nr. 10183, të datës 20 tetor 2009 “për zbatimin e projekteve me rëndësi prioritare”. Ligji për asistencën shtetërore është i vlefshëm për të gjithë sektorët e prodhimit dhe shërbimeve, si edhe të gjitha masat e ndërmarra nga qeveria kombëtare dhe ajo vendore, si edhe nga subjekte të tjera që veprojnë për llogari të shtetit, si dhe për të gjitha llojet e ndërmarrjeve, me përjashtim të atyre në bujqësi dhe në sektorin e peshkimit. Ndërmjet stimujt mund të përmendim:

- Investitorët që ndërtojnë centrale për prodhimin e energjisë me kapacitet të instaluar prej mbi 5 MW përmes përdorimit të lendeve të lengshme, si edhe investitorët që rehabilitojnë centralët ekzistues mund të përfitojnë nga përjashtimi nga taksat doganore për makineritë e importuara dhe pajisjet e përdorura për investime kapitale. Gjithashtu, këtyre investitorëve mund tu rimbursohen taksat doganore dhe akciza që kanë paguar për importin e lëndës djegëse të përdorur për prodhim energjie (Ligji Nr. 8987 i datës 24.02.2002 “për krijimin e kushteve lehtësuese në lidhje me ngritjen e centraleve të reja për prodhimin e energjisë”);
- Importuesit e makinerive dhe pajisjeve mund të përfitojnë nga shtyrja e pagesës së TVSH-së për një periudhë deri në një vit, në rast se makineritë dhe pajisjet përdoren vetëm për aktivitetin ekonomik të importuesit të tatueshëm sipas ligjit nr. 9856 “Për disa ndryshime në ligjin mbi tatimin e vlerës së shtuar të datës 26.12.2007”.

2. Masa në vijim për përmirësimin e mjedisit të biznesit.

Reforma e Albinvest-it

Për ta përshtatur aktivitetin e Albinvest-it me zhvillimet bashkëkohore dhe objektivat e qeverisë, po zbatohet një reformë ristrukturimi i kësaj strukture që do të përfshijë edhe një rishikim të funksioneve të kësaj agjencie. Deri më tani, Albinvest-i ka shërbyer si agjenci promovimi për imazhin e vendit dhe thithjen e investitorëve të huaj dhe vendas. Sipas Indeksit të Reformës së Investimeve të OECD-së për vitin 2010, Shqipëria do të duhet të përqendrohet në përmirësimin e shërbimeve për investitorët gjatë fazave para dhe pas krimit. Raporti rekomandon që kjo agjenci të funksionojë si një “one-stop-shop” për investitorët për

të garantuar shërbime më të shpejta dhe më efikase për investitorët e huaj, por edhe për të lehtësuar bashkërendimin midis institucioneve të ndryshme shtetërore. Aktualisht një ligj i ri dhe pikërisht ai me **Nr. 10303 i datës 15.07.2010** i miratuar nga parlamenti shqiptar shpall krijimin e Agjencisë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA), që është caktuar si agjencia kombëtare për promovimin e investimeve (IPA) dhe do të jetë një aktor shumë i rëndësishëm për thithjen e investimeve të huaja direkte në vend. Sipas këtij ligji, qeveria shqiptare i ka akorduar kësaj agjencie këto detyra:

të lehtësojë dhe mbështesë investimet direkte në Shqipëri përmes identifikimit dhe nxitjes të mundësive për investime, duke ofruar shërbime dhe mbështetje për investitorët ekzistues dhe potencialë;

të rrisë konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke mundësuar rinovimin dhe përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve, si edhe të teknologjive që ato përdorin, duke ofruar mekanizma për të rritur kapacitetet e tyre teknike dhe rritjen e aftësive profesionale;

të nxisë dhe mbështesë eksportin e mallrave dhe shërbimeve, duke garantuar shërbime mbështetëse dhe asistencë financiare për kompanitë eksportuese dhe për nxitjen e eksporteve.

Në kuadrin e veprimtarisë së saj, Agjencia do të kryejë të gjitha aktivitetet dhe do të ndërmarrë iniciativat e nevojshme për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat. Ajo do të ndihmojë në përmirësimin e klimës së biznesit, si edhe do të japë asistencë kompanive private në të gjitha stadet e aktivitetit të tyre ekonomik, si edhe do të ndërmjetësojë me investitorët dhe autoritetet shtetërore. Vëmendje e vecantë do t'i kushtohet zgjidhjes së mangësive në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e projekteve të investimeve, manaxhimit të marrëdhënieve me klientët dhe shërbimeve që do të ofrohen pas vendosjes së investitorëve të huaj.

Gjykata Administrative

Së shpejti pritet që Parlamenti të miratojë një propozim për krijimin e Gjykatës Administrative. Gjykata parashikohet të luajë një rol të rëndësishëm për përshtetimin e procesit administrativ. Qëllimi i ngritjes të gjykatës në fjalë është të përshtetë procedurat që lidhen me apelimet nga bizneset dhe të forcojë masat për ekzekutimin e kontratave.

Nxitja e sipërmarrjes dhe novatorizimit

Si pjesë e planeve të saj strategjike, qeveria shqiptare u ka kushtuar vëmendje të vecantë programeve për rritjen e konkurrueshmërisë të NMV-ve, bazuar në planet e veprimit në lidhje me sipërmarrjen dhe transferimin e teknologjive dhe novatorizimit/novacionit.

Aktualisht, qeveria po ndërmer hapa për përmirësimin e kushteve për nxitjen e sipërmarrjes dhe forcimin e konkurrueshmërisë së ekonomisë. Reformat kanë përmirësuar masat për regjistrimin e ndërmarrjeve përmes Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të biznesit, lëshimit të licencave përmes Qendrës Kombëtare të Licensimit dhe reformës në inspektim, duke ulur numrin e inspektoriateve. Ndërkohë, reforma në sistemin tatimor ka sjelle si rezultat një sistem tatimor me taksa më të ulëta dhe më transparent.

Strategjia e Novatorizimit/Novacionit në Biznes dhe Teknologjisë – që është ende në trajtë projekti/drafti dhe pritet të finalizohet – përcakton kuadrin për ngritjen e institucioneve dhe industrive konkurruese, si edhe për zhvillimin e aftësive profesionale të afta për ta absorbuar dhe përdorur teknologjinë e importuar, si edhe për të sjellë novacione të vërteta

teknologjike. Gjithashtu, pritet ngritja e një Qendre Novacioni për Biznesin (BRIC). Kjo qendër do të vijë në ndihmë bizneseve vendase për të rritur kapacitetet manaxheriale, për të ndërtuar sisteme të përparura të informacionit dhe modelime teknologjike, për të rritur performancën dhe komunikacionin me tregjet e brendshme dhe të jashtme, për të përzgjedhur teknologjinë më të përshtatshme, si edhe për të garantuar strategji më efikase, më shumë qendrueshmëri dhe produktivitet në bizneset e tyre.

Shqipëria është pjesë e Programit të Bashkimit Evropian për Konkureshmërinë dhe Novatorizmin (CIP). Në kuadrin e këtij programi ka tri nën-programe që janë të përqëndruara tek SME-të:

- programi për sipërmarrjen dhe novatorizmin (EIP);
- programi për mbështetjen e politikave ICT; dhe
- Programi i titulluar “Evropa që përdor energjinë me inteligjencë” (IEE).

Programet janë të hapura për të gjitha kompanitë pa dallim pronësie, qofshin të huaja apo vendase.

Planet e privatizimit


Privatizimi i asetëve strategjike shtetërore që kanë mbetur ende pa u privatizuar, kryesisht asetet e kompanisë të naftës Albpetrol, aksioni i pakicës i Shqipërisë në operatorin e telefonisë fikse Albtelecom dhe ai i Institutit të Sigurimeve (INSIG) janë parashikuar për nga fundi i vitit 2010. Gjatë kësaj kohe, konsolidimi i kompanive të privatizuara gjithashtu ka nevojë për monitorim. Pagesa e detyrimeve të kompanisë shëiptare të Rafinerisë & Marketimit të Naftës (ARMO) mund të vërë në rrezik privatizimin e Albpetrol-it dhe rrjedhimisht të sjellë përfundimin e programit të privatizimeve strategjike (FMN, 2010).

Bashkëpunimi dhe asistencë ndërkombëtare

Përpjekjeve të Shqipërisë për forcimin e marrëdhënieve institucionale dhe masave për nxitjen e investimeve të huaja direkte u shtohet edhe bashkëpunimi dhe asistencë teknike e organizatave ndërkombëtare si: Këshilli i Evropës KE, PNUD-i, Banka Botërore/FIAS, UNCTAD etj. Midis këtyre iniciativave të suksesshme mund të përmendim edhe aktivitetet e “lead generation” të organizuara nga agjencia Albinvest, me mbështetjen e KE-PNUD, në kuadrin e Projektit për Liberalizimin dhe Nxitjen e Tregtisë, që targetoi investitorë potencialë dhe u siguroi atyre informacionin përkatës. Roli i saj ilustron nga komentet e mëposhtme të z. Alberto D’Amica, Manaxher i Përgjithshëm i kompanisë *Teleperformance Shqipëria*: që hapi një zyrë në Tiranë në nëntor të vitit 2006 dhe që tashmë ka krijuar 1000 vende pune në vit:

“Vendimi për të investuar në Shqipëri që marrë atëherë, duke qënë se kompania kishte nevojë të shtrihej/hapej në terren në mënyrë urgjente për të përmbushur kërkesat e kompanisë, por ekipet e hulumtimit të investimeve të huaja direkte në Shqipëri (të organizuara me përfaqësues të *call centers* italiane në Romë dhe në Tiranë në muajt qershor dhe shtator 2006, në kuadrin e aktiviteteve të “lead generation” në sektorin e shërbimeve, me mbështetjen e Projektit për Liberalizimin dhe Lehtësimin e Tregtisë të EC-PNUD-it, bëri një punë të mirë në paraqitjen e mundësive që ofronte Shqipëria përsa i takon taksave dhe stabilitetit të vendit dhe luajtën një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e çdo mëdyshjeje në lidhje me vendin”.

|



3. Sektorë specifike për investime të evidentuar dhe promovuar nga qeveria shqiptare

Qeveria shqiptare ka evidentuar një numër sektorësh dhe industrish si fusha për nxitjen e investimeve të huaja. Ato përfshijnë:

Shërbimet e biznesit. Shqipëria ofron mundësi të mira për katër lloje investimesh të huaja të orientuara drejt eksporteve në lidhje me shërbimet e biznesit: qendra mbështetje për konsumatorin, qendra të përbashkëta shërbimesh për përpunimin e të dhëanve, shërbime teknologjike informacioni (TI) dhe qendra rajonale biznesi. Mundësitë më të mira për thithjen e investimeve janë në dy aktivitetet e para (qendra të mbështetjes së klientit dhe përpunim të dhënash) bazuar në disa avantazhe konkurruese si p.sh.: (i) fuqi punëtore e kualifikuar, me njohuri për gjuhë të huaja, (ii) kostot e krahut të punës janë se një e pesta e mesatares të vendeve të Evropës Perendimore dhe (iii) hapësira të disponueshme të përshtatshme për zyra.

Bujqësia dhe agrobiznesi. Shqipëria ka burime të konsiderueshme për zhvillimin e bujqësisë për shkak të kushteve të favorshme klimatike dhe krahut të lirë të punës në zonat rurale. Për shkak të metodave tradicionale të kultivimit të frutave dhe perimeve dhe atyre të përdorura në blegtori, duke përdorur pesticide dhe kimikate në sasira të moderuara, Shqipëria njihet tashmë si një prodhues dhe eksportues i produkteve organike. Në disa nën-sektorë të industrisë agroushqimore ekzistojnë mundësi për investime, ku ndër segmentët më premtues janë ato që kanë potencial eksporti: si p.sh. bimë mjeksore, perime, produkte të konservuara si p.sh.: ullinj apo vaj ulliri, peshk i freskët dhe i përpunuar etj.

Minierat. Shqipëria ka burime të konsiderueshme minerare, duke përfshirë kromin, bakrin, nikelin dhe qymyrin. Industritë nxjerrëse janë në duart e sektorit privat dhe rrjedhimisht ka mundësi për investime të reja në këtë sektor. Gjithashtu, mundësi të reja investimesh mund të ofrohen edhe përmes marrëveshjeve të koncensioneve.

Nafta dhe gazi. Hidrokarburet përbëjnë 62% të bilancit energjetik shqiptar. Kompanitë vendase dhe ndërkombëtare që operojnë në sektor, në aktivitete që nisin që nga eksplorimi dhe prodhimi deri tek shitja dhe marketimi i produkteve të naftës dhe gazit. Në sektorin e hidrokarbureve po vijon procesi i privatizimit. Parashikohet që ky proces të sigurojë eficiencë më të madhe në prodhim, rafineri dhe shitje.

Turizmi. Shqipëria ka burime të konsiderueshme natyrore të turizmit. Vija bregdetare është 450 km e gjatë dhe ka disa nga zonat më të pastra dhe më të bukura bregdetare në Mesdheun Verior. E megjithatë niveli i investimeve të huaja në turizëm është shumë i ulët. Investimet e huaja direkte në turizëm parashikohet të ndihmojnë në zhvillimin e industrisë dhe do të inkurajojnë zhvillimin e infrastrukturës në zonat turistike.

Aktivitetet e sipër shënuara përkrijnë gjithashtu me fushat strategjike të evidentuara në Kuadrin Rajonal Strategjik të USAID-it dhe në Projektin e Konkureshmërisë Sektoriale të Ballkanit Perendimor (Western Balkans Sector Competitiveness Project) të lancuar nga Kompakti i Investimeve për Vendet e Evropës Juglindore (rekomentimet e qershorit 2009). Të dyja këto iniciativa, si edhe qeveria shqiptare i përjashtojnë industrinë e manufakturës si objektiva për investimet e huaja direkte në Shqipëri, për shkak të mungesës së një tradite në manufakturë në vend. Megjithatë, disa projekte ekzistuese të projekteve të investimeve të huaja direkte tregojnë se ka vend për zhvillim në këtë sektor, në vecanti për produktet e destinuar për tregun vendas. Megjithatë, nevojitet një zhvillim i kapitalit njerëzor për të bërë të mundur që Shqipëria të tërheqë gjithmonë e më shumë investime në secilin prej këtyre sektorëve.

C. Vlerësim i mjedisit institucional dhe ligjor në Shqipëri: rezultate të një sondazhi mbi perceptimet për investimet e huaja direkte

Sondazhi në lidhje me perceptimet e investitorëve të huaj që janë aktivë në Shqipëri përsa i takon kuadrin të politikave është kryer gjatë periudhës qershor-korrik 2010 nga FIAA (Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri) dhe projektit Nje OKB mbeshtetje per IHD-te, PNUD-Shqiperi(Kutia III.1)

Kutia III.1. Karakteristikat e sondazhit në lidhje me perceptimet për investimet e huaja direkte në lidhje me kuadrin e politikave në Shqipëri

Ekipi i sondazhit morri 80 përgjigje nga një kampion jo-përfaqësues i ndërmarrjeve të investimeve të huaja. Sondazhi mbuloi afërsisht 13% të filialeve të huaja në vend. Ka disa mospërputhje strukturore midis kampionit dhe popullatës së filialeve të huaja në vend. Në krahasim me bazën e të dhënave të INSTAT-it, të cilës i jemi referuar më parë (në kapitullin I), sondazhi nuk i përfaqëson si dhe sa duhet kompanitë e huaja në manufakturë sikundërse ka një mbipërfaqësim të kompanive në shërbime. Megjithatë, e përqindja e manufakturës si produkt final është shumë e ulët sesa në terma të numri të ndërmarrjeve dhe rrjedhimisht një përfaqësim më i lartë i këtyre kompanive në sondazh justifikohet nga rëndësia e tyre në ekonominë shqiptare. Shpërndarja rajonale e kompanive të anketuara është shumë e ngjashme me atë të filialeve të huaja të bazës së të dhënave të INSTAT-it. Në sondazh pati së paku 75 përgjigje të vlefshme për secilën pyetje të sondazhit. Karakteristikat kryesore të firmave të anketuara janë si më poshtë vijon:

- më shumë se gjysma e tyre ishin të themeluara përpara vitit 2003, ndërsa pjesa tjetër më vonë;
- 59% e kompanive të anketuara ishin krijuar si investime nw biznese tw reja, 24% si rezultat i privatizimeve dhe pjesa tjetër si investime nw projekte ekzistuese;
- 90% e të gjitha kompanive të anketuara ishin kryesisht me pronësi të huaj;
- përsa i përket pronësisë së huaj, 15 kompani (19%) ishin greke, 13 (17%) italiane dhe pesë (6%) austriake; të tjerat ishin themeluar nga kompanitë mëma nga 21 vende të ndryshme;
- përsa i përket aktiviteteve kryesore ekonomike, 34% e të anketuarëve operojnë në manufakturë (gjysma e tyre në tekstil dhe veshmbathje), 21% në miniera, energjetikë dhe ndërtim dhe 45% tjetër në shërbime;
- vetëm një e katërta e kompanive kanë mbi 250 punonjës; pjesa tjetër janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme, sidomos të mesme (33%) që punësojnë nga 50 deri 250 persona;
- shumica e kompanive kanë njohur rritje vitet e fundit, 71% e tyre kishin më shumë të punësuar në vitin 2009 sesa në vitin 2007 dhe 76% e tyre kanë xhiro më të lartë;
- perspektiva për të ardhmen është optimiste, 61% e kompanive presin një rritje të punësimit gjatë dy viteve në vijim, përkundrajt vetëm 13% që parashikojnë ulje (pjesa tjetër parashikon të ruajë nivelin ekzistues të punësimit);

- ka një dallim të qartë midis kompanive eksportuese dhe atyre jo-eksportuese: 46% e kompanive nuk kanë asnjë aktivitet eksporti, ndërsa 29% e tyre eksportojnë më shumë së gjysmën e produktit të tyre final;
- 62% e kompanive janë me qendër në Tiranë, ndërsa pjesa tjetër është e shpërndarë në të gjithë Shqipërinë;

Burimi: FIAA/PNUD-Shqipëri, Anketimi për filialet e huaja.

Investitorët e huaj të anketuar dhanë një vlerësim përgjithësisht pozitiv në lidhje me përshtatshmërinë e politikave ekonomike— 72% e këtyre kompanive janë të mendimit se ato janë “politikave të duhura” ose “pikërisht politikave që duhen”. Megjithatë, një nivel kaq i lartë i kënaqësisë të përgjithshme nuk shkon në të njëjtat linja me përqindjet e përgjigjive për pyetje të ngjashme në fusha individuale të politikave dhe me treguesit e raportit “Të Bësh Biznes” të Bankës Botërore. Shpjegimi mund të jetë që ka një tendencë që sa më e suksesshme të jetë kompania, aq më të mëdha janë gjasat që të marrë pjesë në këto lloj sondazhesh.

Pyetësori testoi sesa të kënaqura ishin filialet e huaja në lidhje me nëntë fusha legjislativë (figura III.2). Një përqindje e lartë e të anketuarëve (70%) u shprehën të kënaqur me barrën tatimore dhe ligjin për punësimin. Këta faktorë përfshijnë kushtet bazë për suksesin e investitorëve. Një përqindje e lartë e investitorëve gjithashtu u shpreh e kënaqur me sistemin e sigurimeve shoqërore dhe me kostot relativisht të ulëta për punëdhënësit. Pakënaqësitë lidheshin kryesisht me zbatimin e legjislacionit, vjeljen e taksave, rimbursimin e TVSH-së dhe burokracinë në përgjithësi.

Afërsisht një e treta e të anketuarëve shprehën pakënaqësi me programet mbështetëse të qeverisë, si përsa i përket strukturës, ashtu edhe përsa i takon aksesit ndaj këtyre programeve. Mesa duket një mjedis liberal në vetvete nuk është i mjaftueshëm për të kënaqur kompanitë, ndaj ato kërkojnë disa stimul të vërtetë.

Një grup tjetër pyetjesh që u drejtohej të anketuarëve kishte të bënte me pengesat dhe vështirësitë që ato hasin. Përgjigjiet tregojnë se tre të katërtat e investitorëve të huaj mund të bazohen në fonde të mjaftueshme dhe gjejnë krah të mjaftueshëm pune për aktivitetet e tyre. Problemi më i madh i evidentuar është se gjysma e këtyre kompanive nuk gjejnë dot njerëz me aftësitë e duhura profesionale. Kjo mund të përkthehet në një nevojë për arsim dhe trainim profesional më të mirë. Për shumicën e kompanive të huaja, zyrat e punës konsiderohen pothuajse të padobishme. Përsa i takon krahut të punës, këto zyra mund të ofrojnë akses sasior por jo cilësor.


Një fushë tjetër problematike e evidentuar është pasiguria e përgjithshme ekonomike, që mund të lidhet si me kushtet regullatore, ashtu edhe me ato të tregut. Në komentet me shkrim përmendej gjithashtu edhe një komunikim i vështirë/i komplikuar me autoritetet.

Garancia e aksesit ndaj pronave të paluajtshme në praktikë nuk funksionon sic duhet. Kjo është sidomos e vërtetë po të dalësh jashtë Tiranës, ku është e vështirë për të regjistruar dhe për të marrë garanci për të drejtat e pronësisë. Një problem i ngjashëm ka të bëjë edhe me licencat që kompanitë e huaja e kanë vështirë t'i sigurojnë, ndërsa disa konkurrentë lokalë marrin licenca fallso.

Përgjigjet tregojnë se aktiviteti i investitorëve të huaj zakonisht është i bazuar në plane të zhvillimit strategjik. Pjesa më e madhe e kompanive janë të përfshira së paku me raste në projekte të kërkimit –shkencor dhe zhvillimit (R&D). Nga kompanitë e angazhuara në këto lloje projektesh, 48% bashkëpunojnë me kompani apo organizata të tjera. Më shumë se një e treta e tyre ka bashkëpunim me universitetet. Këta tregues janë provë e transferimit të teknologjisë.

Marrëdhëniet tregtare dhe ato të rrjeteve karakterizohen nga një mbizotërim i lëndës së parë të importuar dhe shitje në vend të produktit. Kjo provë sugjeron orientimin e kompanive drejt tregut lokal dhe rallë një orientim drejt eksportit të sipër përmendur. Por sigurisht që orientimi drejt eksportit ndryshon për aktivitete të vecanta ekonomike.


Figura III.2. Sa të kënaqura janë filialet e huaja me kuadrin ligjor për biznesin në Shqipëri (përqindja e përgjigjeve të sondazhit)



Burimi: FIAA/PNUD Sondazh me ndërmarrjet e investimeve të huaja në Shqipëri

Mbështetja e qeverisë parashikohet në formën e strukturave mbështetëse si: qendra biznesi, parqe industriale, shërbimet e agjencisë Albinvest dhe zonat e lira ekonomike. Qendrat e biznesit janë më të njohura për kompanitë e anketuara sesa organizatat e tjera, ndonëse të anketuarit i evidentojnë ato me Dhomat e Tregtisë. Sipas sondazhit, 60-70% e investitorëve nuk janë të familjarizuar me strukturat e tjera mbështetëse, duke përfshirë agjencinë e nxitjes së investimeve, Albinvest, dhe shumica e kompanive nuk i përdor ato (figura III.3).

Figura III.3. Sa të familjarizuara janë filialet e huaja dhe si i përdorin ata strukturat mbështetëse të biznesit (numri i përgjigjeve)



Burimi: FIAA/PNUD Sondazh me ndërmarrjet e investimeve të huaja në Shqipëri

Si konkluzion, rezultatet e sondazhit paraqesin një panoramë pozitive të aktiviteteve të qeverisë në mbështetje të investimeve dhe mjedisit të biznesit. Megjithatë ka edhe disa mangësi të rëndësishme që dalin në pah nga sondazhi, si edhe disa kërkesa për përmirësime. Këto kërkesa duhen marrë në konsideratë me kujdes. Kompanitë zakonisht kanë një qëndrim të përzjerë në lidhje me politikat e shtetit, në vecanti në lidhje me taksat. Nga njëra anë, ato janë të kënaqura me përqindjet e ulëta të taksave dhe nivelin e ulët të barrës fiskale, ose kërkojnë edhe më pak. Nga ana tjetër, ato kërkojnë përmirësim të shërbimeve publike, gjë që në vetvete kërkon shpenzimin e më shumë fondeve nga shteti: si p.sh. infrastrukturë më të mirë, krah pune më të kualifikuar, mbështetje nga shteti, parqe industriale, si edhe lehtësi për punë kërkimore-shkencore dhe zhvillimi. Rrjedhimisht i takon qeverisë të vendosë një balancë midis të ardhurave dhe shpenzimeve në lidhje me politikat fiskale për të garantuar një zhvillim ekonomik afatgjatë.

D. KONKLUZIONE NË LIDHJE ME POLITIKAT

Shqipëria ka tërhequr një numër jashtëzakonisht të lartë të investimeve të huaja direkte në vitet e fundit. Në sektorë kyçë si: në miniera, banka dhe telekomunikacion, ekonomia shqiptare dominohet nga investimet e huaja. Megjithatë, stoku i investimeve të huaja direkte përkundrajt GDP-së ende mbetet i ulët në krahasim me vende të tjera të rajonit. Kjo sugjeron që ka vend për shtim të investimeve të huaja direkte në vend. Për të ruajtur nivelin e investimeve të huaja direkte në vend të viteve 2008-09, apo për ta rritur atë edhe gjatë viteve në vijim nevojitet një përmirësim i kuadrit institucional, administrative dhe teknike për IHD-të, targetim i duhur dhe mbështetje nga ana e qeverisë. Privatizimi ka qënë një katalizator i rëndësishëm për tërheqjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri. Tashmë procesi i privatizimit pothuajse ka përfunduar, tërheqjen e llojeve të tjera të investimeve do të kthehet në prioritet.

Njëkohësisht është me rëndësi që llojet e investimeve të huaja direkte që do të vijnë në vend të jenë ato nga e cila ekonomia e vendit do të mund të përfitojë. Përqindja e lartë e investimeve të huaja direkte në disa industri të caktuara të vendit është kryesisht një shenjë dobësie nga ana e ndërmarrjeve me pronësi lokale të këtyre industrive. Kjo mund të përbëjë një problem, duke qënë se një sector lokal SME-sh që nuk ka zhvillimin e duhur pengon punësimin dhe mund të jetë shkak për importe të larta. Hendeku i produktivitetit të krahut të punës midis filialeve të huaja dhe kompanive vendase është relativisht i ngushtë në industrinë e manufakturës, gjë që flet për një nivel relativisht të ulët teknologjik të filialeve të huaja. Në sektorin e telekomunikacioneve ka disa pengesa në telefoninë që mund të pengojnë zhvillimin e shërbimeve online. Përsa i përket shërbimeve të sistemit bankar, që tani është kryesisht në pronësi të kompanive të huaja, primet e riskut për kreditë për SME-të janë të larta, ndërsa nevojiten edhe agjenci për garantimin e kredive me qëllimin për mirësimin e aksesit financiar.

Thithja e investimeve të huaja direkte dhe rritja e konkureshmërisë të kompanive vendase janë element vitalë për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm në Shqipëri. Politika e investimeve të huaja direkte është pjesë e politikave për të realizuar atë qëllim. Gjatë viteve të fundit, sic përmendet në kapitullin III, veprime të rëndësishme janë ndërmarrë drejt përmirësimit të klimës së investimeve përmes reformës institucionale dhe regullatore, rritjes së disponueshmërisë së fondeve për investime, zhvillimit të infrastrukturës, përmirësimit të kushteve për tregtinë e lirë dhe integrim rajonal.

Gjithashtu nevojiten reforma të mëtejshme në fushën e administrimit tatimor dhe doganor, në përdorimin e tokës dhe lejet e ndërtimit, në sistemin e apelimit administrative, në sistemin e inspektimit dhe e-government. Investitorët kërkojnë ndërmarrjen e hapave për përmirësimin e zbatimit të legjislacionit, mbledhjes së taksave, rimbursimin e TVSH-së dhe uljen e burokracisë. Duhet përmirësuar vërtetimi/certifikimi i pronësisë, si edhe duhet thjeshtuar lëshimi i të gjitha lejeve. Procedurat jo-transparente shkaktojnë vonesa dhe mund të bëhen premisë për korrupsion.

Investitorët, duke përfshirë e investitorët e huaj, janë të kënaqur nga përqindjet e ulëta të taksave dhe nivelin e ulët të barrës fiskale që mbizotëron në Shqipëri, por ata gjithashtu kërkojnë shërbime efikase publike, që kërkojnë më shumë fonde nga ana e qeverisë. Këtu përfshihet një infrastrukturë më e mirë, një krah punë më i kualifikuar, mbështetje nga qeveria, parqe industriale dhe lehtësitë e punës-kërkimore shkencore dhe të zhvillimit. Qeveria duhet të vendosë një balancë midis dy anëve të politikës fiskale, në përpjekjet e saj për të tërhequr dhe për të përfituar nga investimet e huaja direkte. Ndërsa përqindjet e taksave

janë një factor në konkurrencën për thithjen e investimeve në vend, të ardhurat fiskale që nevojiten për të financuar investimet publike dhe shërbimet duhet të rriten.

Qeveria ka njohur rolin e rëndësishëm të infrastrukturës në nxitjen e investimeve të huaja direkte dhe në zhvillimin e ekonomisë. Janë rehabilituar disa rrugë dhe porte, shpesh përmes skemave të partneritetit publik- privat. Ligji për koncensionet ka hapur dritën jeshile për projektet PPP edhe në sektorin e energjetikë, me qëllim rritjen e prodhimit të energjisë elektrike.

Për rritjen e përqindjes që zë tregu shqiptar në atë rajonal, si edhe cilësinë e shërbimeve dhe të fluksit të investimeve të huaja direkte kërkohet një integrim edhe më i madh rajonal përmes zbatimit të plotë të marrëveshjes CEFTA 2006. Kjo është me rëndësi sepse në mungesë të saj, ndërmarrjet e investimeve të huaja në Shqipëri e konsiderojnë si të pamjaftueshëm aksesin e tyre në tregje. Tregu vendas është i vogël dhe masa e tregjeve ndërkombëtare lehtësisht të aksesueshme duhet të zgjerohet. Kostot e eksportit nga Shqipëria janë shumë të larta në krahasim me ato ndërkombëtare.

Vëmendje e vecantë i duhet kushtuar përmirësimit të ekonomisë së dijeve dhe shoqërisë së informacionit në Shqipëri përmes futjes dhe aplikimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit, si edhe përmes përmirësimit të rezultateve arsimore.

. Duhet marrë në konsideratë politika specifike në favour të investimeve në zonat më pak të zhvilluara për të reduktuar pabarazitë e zhvillimit rajonal. Krjimi i parqeve industrial në fusha specifike mund të kontribuojë në thithjen e investimeve të reja në këto fusha. Investitorët kanë shprehur dëshirën që parqet industriale të bëhen gati për investime së shpejti.

Investitorët i përdorin fare pak shërbimet e Albinvest-it. Agjencia duhet vënë në pozitë për tu shërbyer më shumë investitorëve dhe për ta bërë një gjë të tillë me më shumë efikasitet. Qeveria po punon për ngritjen e pozicionit të Albinvest-it në një ofrues të shërbimeve të biznesit dhe një pikë hyrjeje one-stop-shop për investitorët e huaj. Përqëndrimi i përpjekjeve të Albinvest-it për tërheqjen e IHD-ve dhe vecanerisht të investimeve të reja mund të sjellin përfitime në të ardhmen për vendin. E me qëllim që këto përpjekje të rezultojnë të sukseshme, do të jetë e nevojshme që të bëhet një azhurmim dhe ngritje jo vetëm e pozicionit të agjencisë së investimeve, por edhe të personelit dhe kuadrit të saj, bashke me fondet, me qëllim që agjencia ta ketë të mundur të kërkojë në mënyrë aktive për investitorë dhe të moderojë hyrjen e tyre në vend. Një detyrë tjetër e Albinvest-it duhet të jetë që t'ia transmetojë nevojat dhe problemet e investitorëve qeverisës dhe për të inkurajuar ri-investimin e fitimeve. Gjithashtu, thithja e IHD-ve dhe përmirësimi i kushteve për to nuk duhet të jetë detyrë vetëm e një agjencie qeveritare, por edhe e të gjitha ministrive dhe të administrative rajonale dhe lokale.

REFERENCAT

BERZH (2010a), Raporti i Tranzicionit : “Ringjallja dhe Reformat”, Nentor 2010, Londer

BERZH (2010b), *Legjislacioni tregtar në Shqipëri: Një vlerësim*, janar 2010, Londër: Komisioni Evropian (2010) "*Strategjia e Zgjerimit dhe Raportet e Progresit 2010*", nëntor 2010, Bruksel: Komisioni Evropian.

Holzner, Mario (2010), “Shqipëria: Pjesë e një Tragjedie Greke?": Vladimir Gligorov, Peter Havlik, Michael Landesmann, Josef Pöschl, Sándor Richter etj., *Kriza kaloi, por përpara mbeten problemet (Crisis Is Over, but Problems Loom Ahead)*, WIIW Analiza aktuale dhe parashikimet: Perspektiva ekonomike për Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore, botimi nr. 5, shkurt 2010. Vienë: Instituti i Vienës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare.

Hunya, Gábor (2010). *WIIW Baza e të dhënave për investimet e huaja direkte në Evropën Qëndrore, Lindore dhe Juglindore, 2010: IHD-të në CEEC të prekura thellë nga kriza globale*. Vienë: Instituti i Vienës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare

Görg, H. and Greenaway, D. (2001) “Foreign direct investment and intra-industry spillover: A review of the literature” Research Paper No. 37, University of Nottingham.

Fondacioni Heritage Foundation (2010). "*2010 Indeksi i Lirisë Ekonomike- lidhja midis Mundësive Ekonomike dhe Begatisë* " Heritage Foundation.

FMN (2010), Shqipëria—2010 Neni IV Konsultimet, Konkluzione Paraprake të Misionit, 10 mars 2010 <http://www.imf.org/external/np/ms/2010/031010.htm>, Uashington, D.C.: FMN.

Field Code Changed

FMN (2010), *Parashikimi Ekonomik Botëror: Rimëkëmbja, Risku dhe Ri-balancimi*. Uashington, D.C.: FMN.

OECD (2010). "*Indeksi i Reformës së Investimeve- Evropa Juglindore, viti 2010: Politikat e Monitorimit dhe Institucionet e Investimeve Direkte* ", Paris: OECD

UNCTAD (WIR02). *Raporti i Investimeve Botërore për vitin 2002: Korporatat shumëkombëshe dhe konkurrencshmëria e eksporteve (Transnational Corporations and Export Competitiveness)*. Nju Jork dhe Gjenevë: Kombet e Bashkuara.

UNCTAD (WIR06). *Raporti i Investimeve Botërore për vitin 2006: IHD-të nga ekonomitë në zhvillim dhe në tranzicion- implikimet në kuadrin e zhvillimit*. Nju Jork dhe Gjenevë: Kombet e Bashkuara.

UNCTAD (WIR10). *Raporti i Investimeve Botërore për vitin 2010: Të investosh në një ekonomi me emetim të ulët karboni*. Nju Jork dhe Gjenevë: Kombet e Bashkuara.

OBT (Organizata Botërore e Tregtisë) (2010): "*Rishikimi i politikave tregtare - Shqipëria 2010*". Gjenevë: Zvicër.

World Bank 2010: Investimi ndërmjet Kufijve 2010, Indikatorët e rregullave të HDI-ve në 87 vende., World Bank DC, 2010

EBRD (2010a), *Transition report: Recovery and reform*", November 2010, London: EBRD.

EBRD (2010b), *Commercial Laws of Albania: An Assessment*, January 2010, London: EBRD.

European Commission (2010), "*Enlargement Strategy and Progress Reports 2010*", November 2010, Brussels: European Commission.

Holzner, Mario (2010), "Albania: Part of a Greek tragedy?" in: Vladimir Gligorov, Peter Havlik, Michael Landesmann, Josef Pöschl, Sándor Richter et al., *Crisis Is Over, but Problems Loom Ahead*, WIIW Current Analyses and Forecasts: Economic Prospects for Central, East and Southeast Europe, No. 5, February 2010. Vienna: Vienna Institute for International Economic Studies.

Heritage Foundation (2010). "*2010 Index of Economic Freedom, the link between Economic Opportunity and Prosperity*" Heritage Foundation.

Hunya, Gábor (2010). *WIIW Database on Foreign Direct Investment in Central, East and Southeast Europe, 2010: FDI in the CEECs Hit Hard by the Global Crisis*. Vienna: Vienna Institute for International Economic Studies.

Görg, H. and Greenaway, D. (2001) "Foreign direct investment and intra-industry spillover: A review of the literature" Research Paper No. 37, University of Nottingham.

IMF (2010), Albania—2010 Article IV Consultation, Preliminary Conclusions of the Mission, March 10, 2010, <http://www.imf.org/external/np/ms/2010/031010.htm>, Washington, D.C.: IMF.

Field Code Changed

IMF (2010), *World Economic Outlook: Recovery, Risk and Rebalancing*. Washington, D.C.: IMF.

OECD (2010). "*South East Europe - Investment Reform Index 2010: Monitoring Policies and Institutions for Direct Investment*", Paris: OECD

UNCTAD (WIR02). *World Investment Report 2002: Transnational Corporations and Export Competitiveness*. New York and Geneva: United Nations.

UNCTAD (WIR06). *World Investment Report 2006: FDI from Developing and Transition Economies – Implications for Development*. New York and Geneva: United Nations.

UNCTAD (WIR10). *World Investment Report 2010: Investing in a Low- Carbon economy*. New York and Geneva: United Nations.

WTO (World Trade Organization) (2010): "*Trade Policy Review - Albania 2010*". Geneva: WTO

Banka Botërore, IFC, *Të bësh biznes, 2011:Të sjellësh ndryshimin për sipërmarrjet*, botim i përbashkët i Palgrave MacMillan, IFC dhe Bankës Botërore (Uashington D.C.: Bank

World Bank (2010). "*Investing across borders 2010, Indicators of foreign direct investment regulations in 87 countries*". Washington, D.C.: World Bank.

